

## VENDIM

Nr. 192, datë 4.4.2018

### PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR ASHENSORËT DHE KOMPONENTËT E SIGURISË PËR ASHENSORË DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA”<sup>2</sup>

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 2, e 16, pika 6, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

<sup>2</sup> Vendimi përafron plotësisht Direktivën 2014/33/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë”.

2. Përcaktimi i standardeve të harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për konformitetin e ashensorëve dhe të komponentëve të sigurisë me kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në rregullin teknik të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 1057, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik, “Për ashensorët dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

### RREGULL TEKNIK PËR ASHENSORËT DHE KOMPONENTËT E SIGURISË PËR ASHENSORË DHE PËRCAKTMI I LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

#### 1. Objekti dhe fusha e përdorimit

1. Ky rregull teknik zbatohet për ashensorët që shërbejnë në mënyrë të përhershme në ndërtesa dhe konstruksione dhe të parashikuara për transportin e:

- a) njerëzve;
- b) njerëzve dhe mallrave;
- c) vetëm mallrave, nëse platforma ngritëse lejon që një njeri mund të hyjë pa vështirësi dhe të përshtatet me pajisjet e kontrollit të vendosura brenda platformës ngritëse ose qëndrimin e njeriut brenda saj.

Ky rregull teknik zbatohet gjithashtu dhe për komponentët e sigurisë për ashensorë, të listuar në aneksin III, që përdoren në ashensorët e referuar në nënparagrin e mësipërm.

#### 2. Ky rregull teknik nuk zbatohet për:

- a) pajisjet ngritëse, shpejtësia e të cilave nuk është më e madhe se 0.15 m/sek.;
- b) pajisjet ngritëse të përdorura në kantieret e ndërtimit;
- c) teleferikët, duke përfshirë mjetet hekurudhere me tërheqje me kavo;

c) ashensorët e projektuar dhe të konstruktuar vetëm për qëllime ushtarake dhe policore;

d) pajisjet ngritëse me të cilat mund të kryhen punime;

dh) ashensorët që përdoren në puset e minierave;

e) pajisjet ngritëse që përdoren në teknikën skenike të parashikuara për lëvizjen e aktorëve gjatë interpretimeve artistike;

ë) pajisjet ngritëse të instaluara në mjetet e transportit;

f) pajisjet ngritëse të vendosura në makineri dhe të parashikuara vetëm për të arritur në vendin e punës duke përfshirë këtu pikat e mirëmbajtjes dhe të inspektimit mbi makineri;

g) trena të tipit kremaliere-pinion;

gj) shkallët lëvizëse dhe vendkalimet mekanike.

3. Ky rregull teknik nuk zbatohet ose ndalohet të zbatohet për ashensorë ose komponentë të sigurisë për ashensorë, në rastin kur risqet e referuara në këtë rregull teknik mbulohen tërësisht ose pjesërisht nga rregulla teknike të veçanta.

#### 2. Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, për qëllime të këtij rregulli teknik, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Ashensor" është një mjet ngritës që shërben në lartësi (kate) të veçanta, që ka një platformë ngritëse që lëviz përgjatë udhëzuesve, të cilët janë të shtangët dhe të pjerrët në një kënd më të madh se 15 gradë me horizontin ose një pajisje ngritëse që lëviz përgjatë një drejtimi të përcaktuar edhe kur nuk lëviz përgjatë udhëzuesve të shtangët.

2. "Platformë ngritëse" është pjesa e ashensorit në të cilën njerëzit dhe/ose mallrat mbështeten me qëllim që të ngrihen ose të ulen.

3. "Model ashensori" është një ashensor përfaqësues, dokumentacioni teknik i të cilit tregon mënyrën se si përbushen kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I për ashensorët që janë në konformitet me ashensorin model, i përcaktuar nga parametra objektivë dhe që përdor komponentë të njëjtë të sigurisë.

4. "Bërje e disponueshme në treg" është çdo furnizim i një komponenti të sigurisë për ashensorë për shpërndarje ose përdorim në tregun shqiptar gjatë një veprimtarie tregtare me ose pa pagesë.

5. "Vendosja në treg" është:

a) bërja e disponueshme për herë të parë në treg e komponentit të sigurisë për ashensorë; ose

b) furnizimi i një ashensori në tregun shqiptar në rrjedhën e një aktiviteti tregtar, me ose pa pagesë.

6. "Instalues" është personi fizik ose juridik që merr përgjegjësinë për projektimin, prodhimin, instalimin dhe vendosjen në treg të ashensorit.

7. "Prodhues" është çdo person fizik ose juridik që prodhon një komponent të sigurisë për ashensorë ose ka një komponent të sigurisë për ashensorë të projektuar ose të prodhuar dhe e tregton atë nën emrin e tij ose markën tregtare.

8. "Përfaqësues i autorizuar" është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Shqipëri, i cili ka marrë një akt përfaqësimi nga një instalues ose prodhues për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra specifike.

9. "Specifikim teknik" është një dokument që përshkruan kërkesat teknike që duhet të përbushen nga një ashensor ose një komponent i sigurisë për ashensorë.

10. "Kthim" në lidhje me një ashensor është çdo masë që synon kthimin mbrapsht të një ashensori dhe në lidhje me një komponent të sigurisë është çdo masë që synon kthimin mbrapsht të komponenti të sigurisë për ashensorë që aktualisht është në dispozicion të instaluesit ose të përdoruesit të fundit.

11. "Tërheqje" është çdo masë që synon parandalimin e një komponenti të sigurisë për ashensorë në zinxhirin e furnizimit për të qenë i disponueshëm në treg.

12. "Legjislacion i harmonizuar" është çdo legjislacion që harmonizon kushtet për tregimin e produkteve.

#### 3. Lëvizja e lirë

1. Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg apo vënia në shërbim e ashensorëve ose bërja e disponueshme në treg e komponentëve të sigurisë për ashensorë në territorin shqiptar kur ato janë në përputhje me këtë rregull teknik.

2. Ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorë, që nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik, mund të paraqiten në panaire, ekspozita ose në demonstrime të veçanta vetëm nëse një shënim qartësish i dukshëm tregon se këta ashensorë ose komponentët e sigurisë për ashensorë nuk janë në përputhje me këtë rregull

teknik dhe nuk bëhen të disponueshëm në treg deri sa të sillen në konformitet. Gjatë demonstrimeve merren masat e nevojshme të sigurisë për të garantuar mbrojtjen e personave.

4. Vendosja në treg, bërja e disponueshme në treg dhe vendosja në shërbim

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut (në vijim, ISHMT) merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se ashensorët e mbuluar nga ky rregull teknik mund të vendosen në treg dhe në shërbim vetëm nëse ato janë në përputhje me këtë rregull teknik, kur instalohen, mirëmbahen dhe përdoren brenda qëllimit të tyre të parashikuar.

2. ISHMT-ja merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se komponentët e sigurisë për ashensorë, të mbuluar nga ky rregull teknik, bëhen të vlefshëm në treg dhe vendosen në shërbim vetëm kur ato janë në përputhje me këtë rregull teknik kur ato inkorporohen, mirëmbahen dhe përdoren brenda qëllimit të tyre të parashikuar në përputhje me këtë rregull teknik.

5. Kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë

1. Ashensorët e mbuluar nga ky rregull teknik plotësojnë kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I.

2. Komponentët e sigurisë për ashensorë, të mbuluar nga ky rregull teknik, plotësojnë kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I dhe mundësojnë që ashensorët ku inkorporohen të plotësojnë këto kërkesa.

6. Ndërtesarat dhe konstruksionet ku instalohen ashensorët

1. ISHMT-ja merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që personi përgjegjës për punën në ndërtim ose në ndërtim dhe instaluesi të sigurojnë për njëri-tjetrin informacionin e nevojshëm dhe të marrin hapat e nevojshëm, me qëllim që të sigurojnë funksionimin dhe përdorimin e sigurt të ashensorit.

2. ISHMT-ja merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që hapësirat e parashikuara për ashensorët të mos kenë tubacione, instalime elektrike ose instalime të tjera të ndryshme nga ato të nevojshme për funksionimin dhe sigurinë e ashensorit.

7. Detyrimet e instaluesit

1. Kur vendoset një ashensor në treg,

instaluesi siguron se ai është projektuar, prodhuar, instaluar dhe testuar në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

2. Instaluesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen ose e ka kryer procedurën përkatëse të vlerësimit të konformitetit, si të referuar në pikën 15.

Në rastin kur përputhshmëria e ashensorit me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë është e demonstruar nga kjo procedurë, instaluesi harton deklaratën EU të konformitetit, siguron që ajo e shoqëron ashensorin dhe vendo markimin CE.

3. Instaluesi mban dokumentacionin teknik, deklaratën EU të konformitetit dhe, sipas rastit, vendimin/et e miratimit për 10 vjet mbasi ashensori është vendosur në treg.

4. Kur shikohet e përshtatshme lidhur me risqe të paraqitura në një ashensor, instaluesi, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër të ankesave dhe mospërputhjeve të ashensorit.

5. Instaluesi siguron që në ashensor të jetë vendosur tipi, partia ose numri serial ose elemente të tjera që lejojnë identifikimin e tyre.

6. Instaluesi tregon në ashensor emrin e tij, emrin tregtar të regjistruar dhe adresën postare ku ai mund të kontaktohet. Adresa tregon një pikë të vetme ku instaluesi mund të kontaktohet. Detajet e kontaktit të janë në shqip.

7. Instaluesi siguron që ashensori shoqërohet nga instrukzionet e referuara në nënpikën 7.2 të aneksit I, në shqip ose në një gjuhë lehtësish të kuptueshme nga përdoruesit e fundit, si është e përcaktuar nga ISHMT-ja. Instrukzionet, si dhe çdo etiketim të janë të qarta dhe të kuptueshme.

8. Instaluesi, i cili konsideron ose ka arsyet e besojë se një ashensor, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull teknik, ai menjëherë merr masat e nevojshme korriguese për të sjellë ashensorin në konformitet. Për më tepër, në rastin kur ashensori paraqet një risk, instaluesi informon menjëherë ISHMT-në, duke i dhënë detaje, veçanërisht mbi mospërputhjet dhe masat korriguese të ndërmarra.

9. Instaluesi, sipas një kërkese të arsyetur nga ISHMT-ja, i siguron atij të gjithë

informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e ashensorit me këtë rregull teknik, në një gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga ISHMT-ja.

Instaluesit bashkëpunojnë me ISHMT-në, me kërkesën e tij, për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar risqet që vijnë nga ashensorët që ata i kanë vendosur në treg.

#### 8. Detyrimet e prodhuesit

1. Kur vendos në treg komponentët e tij të sigurisë për ashensorë, prodhuesi siguron se ata janë të projektuar dhe të prodhuar sipas referimit në pikën 5.2.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin e kërkuar teknik dhe kryen ose ka kryer procedurën përkatëse të vlerësimit të konformitetit sipas referimit në pikën 14.

Në rastin kur përputhet komponenti i sigurisë për ashensorë me kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të demonstruara nga kjo procedurë, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit, siguron se ajo e shoqëron komponentin e sigurisë për ashensorë dhe vendos markimin CE.

3. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik, deklaratën EU të konformitetit dhe, sipas rastit, vendimin/et e miratimit për 10 vjet mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë eshtë vendosur në treg.

#### 9. Përfaqësuesi i autorizuar

1. Një prodhues ose instalues mund të zgjedhë një përfaqësues të autorizuar me një akt përfaqësimi.

Detyrimet e dhëna në pikën 7.1 ose në pikën 8.1 dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik të referuar në pikën 7.2 ose në pikën 8.2 nuk janë pjesë e mandatit të përfaqësuesit të autorizuar.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të marrë nga prodhuesi ose instaluesi. Akti i përfaqësimit i lejon përfaqësuesit të autorizuar të kryejë së paku detyrimet e mëposhtme:

a) të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe, në rastin kur kërkohet, vendimin/et e miratimit të lidhura me sistemin e cilësisë së prodhuesit ose instaluesit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të ISHMT-së për 10 vjet mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë eshtë vendosur në treg;

b) sipas një kërkesë të arsyetur nga ISHMT-

ja, të sigurojë për këtë autoritet të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e komponentit të sigurisë për ashensorë ose ashensorin;

c) të bashkëpunojë me ISHMT-në, sipas një kërkesë të autoritetit, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e risqeve të shfaqura nga komponenti i sigurisë për ashensorë ose ashensori, të mbuluara nga akti i përfaqësimit i përfaqësuesit të autorizuar.

#### 10. Detyrimet e importuesit

Importuesi, për një periudhë 10-vjeçare pasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, mban një kopje të deklaratës EU të konformitetit dhe, sipas rastit, vendimin/et e miratimit, në dispozicion të ISHMT-së dhe siguron se dokumentacioni teknik mund të vihet në dispozicion sipas një kërkesë të bërë.

#### 11. Detyrimet e shpërndarësve

Në rastin kur komponenti i sigurisë për ashensorë paraqet një risk, shpërndarësi menjëherë informon ISHMT-në, duke dhënë hollësi, veçanërisht për mospërputhjet dhe masat korriguese të marra.

#### 12. Identifikimi i operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë, sipas një kërkesë, identifikojnë tek ISHMT-ja:

a) çdo operator ekonomik, i cili i ka furnizuar me komponentë të sigurisë për ashensorë;

b) çdo operator ekonomik të cilin e ka furnizuar me komponentë të sigurisë për ashensorë.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e referuar në paragrafin e parë dhe të dytë për 10 vjet mbasi ata janë furnizuar ose kanë furnizuar me një komponent të sigurisë për ashensorë.

#### 13. Prezumimi i konformitetit të ashensorëve dhe komponentëve të sigurisë për ashensorë

Ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë, të cilët janë në konformitet me standarde harmonizuara ose me pjesë të tyre, referimet e të cilave janë pjesë e këtij rregulli teknik, prezumohen se janë në konformitet me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I, të mbuluara nga këto standarde ose pjesë të tyre.

#### 14. Procedurat e vlerësimit të konformitetit për komponentët e sigurisë për ashensorë

Komponentët e sigurisë për ashensorë janë subjekt i njërsë prej procedurave të mëposhtme të

vlerësimit të konformitetit:

a) modeli i komponentit të sigurisë për ashensorë dorëzohet për shqyrtimin EU të tipit si të dhënë në pjesën A të aneksit IV dhe konformiteti i tipit sigurohet me kontrollin rastësor të komponentit të sigurisë për ashensorë, si të dhënë në aneksin IX;

b) modeli i komponentit të sigurisë për ashensorë dorëzohet për shqyrtimin EU të tipit si të dhënë në pjesën A të aneksin IV dhe është subjekt i konformitetit të tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit në përputhje me aneksin VI;

c) konformiteti i bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë, si të dhënë në aneksin VII.

15. Procedurat e vlerësimit të konformitetit për ashensorët

1. Ashensorët i nënshtrohen njërsë prej procedurave të mëposhtme të vlerësimit të konformitetit:

a) nëse ata janë të projektuar dhe të prodhuan në përputhje me një model ashensori që i është nënshtruar një shqyrtimi EU të tipit, si të dhënë në pjesën B të aneksit IV:

i) inspektimi përfundimtar për ashensorë, si e dhënë në aneksin V;

ii) konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit për ashensorë, si e dhënë në aneksin X;

iii) konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së prodhimit për ashensorë, si e dhënë në aneksin XII;

b) nëse ata janë projektuar dhe prodhuan nën një sistem të aprovuar të cilësisë në përputhje me aneksin XI:

i) inspektimi përfundimtar për ashensorë, si e dhënë në aneksin V;

ii) konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit për ashensorë, si e dhënë në aneksin X;

iii) konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së prodhimit për ashensorë, si e dhënë në aneksin XII;

c) konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë për ashensorë, si e dhënë në aneksin VIII;

ç) konformiteti i bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë, duke shtuar shqyrtimin projektit për ashensorët, si e dhënë në aneksin XI.

2. Në rastet e referuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 15.1, në rastin kur personi përgjegjës për projektimin dhe prodhimin e ashensorit dhe

personi përgjegjës për instalimin dhe testimin e ashensorit nuk janë të njëjtë, i pari i ofron të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm që t'i mundësojë këtij të fundit të sigurojë instalimin e duhur dhe të sigurt dhe testimin e ashensorit.

3. Të gjitha variantet e lejuara ndërmjet modelit të ashensorit dhe pjesëve formuese të ashensorëve që rrjedhin nga modeli i ashensorit duhet të jenë qartësish të specifikuara (me vlerat maksimale dhe minimale) në dokumentacionin teknik.

4. Nga llogaritjet dhe/ose në bazë të planeve të projektimit lejohet të demonstrohet ngashmëria e një sërë pajisjeve për të plotësuar kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

#### 16. Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit thekson se është demonstruar përbushja e kërkesave thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

2. Deklarata EU e konformitetit, me strukturën e modelit të dhënë si në aneksin II, përmban elementet e specifikuara në anekset V–XII dhe vazhdimesh duhet të përditësohen. Ajo përkthehet në gjuhën shqipe.

3. Në rastin kur një ashensor ose një komponent i sigurisë për ashensorë është subjekt i më shumë se një akti ligjor që kërkon një deklaratë EU të konformitetit, hartohet vetëm një deklaratë EU e konformitetit në lidhje me aktet e tjera ligjore. Kjo deklaratë përmban identifikimin e akteve ligjore në fjalë, duke përfshirë dhe referimet e tyre të publikimit.

4. Mbas hartimit të deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e komponentit të sigurisë për ashensorë dhe instaluesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e ashensorit me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik.

#### 17. Parime të përgjithshme për markimin CE

Markimi CE është subjekt i parimeve të përgjithshme të dhëna në nenin 9, të ligjit nr. 10489, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

18. Rregullat dhe kushtet për fiksimin e markimit CE dhe markimeve të tjera

1. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në çdo platformë ngritëse dhe në çdo komponent të sigurisë për ashensorë ose, në rastin kur nuk

mundësohet, në një etiketë të vendosur në mënyrë të paheqshme te komponenti i sigurisë për ashensorë.

2. Markimi CE vendoset përpara se ashensori ose komponenti i sigurisë për ashensorë të vendoset në treg.

3. Markimi CE për ashensorët pasohet nga numri i identifikimit i një organizmi evropian të notifikuar/degë e tij e regjistruar dhe e miratuar në Shqipëri nga ministri përgjegjës për tregtinë (në vijim, organ i miratuar, OM), i përfshirë në një nga procedurat e mëposhtme të vlerësimit të konformitetit:

a) inspektimi përfundimtar, si e dhënë në aneksin V;

b) verifikimi i njësisë, si e dhënë në aneksin VIII;

c) sigurimi i cilësisë, si e dhënë në anekset X, XI ose XII.

4. Markimi CE për komponentët e sigurisë për ashensorë pasohet nga numri i identifikimit i OM-së të përfshirë në një nga procedurat e mëposhtme të vlerësimit të konformitetit:

a) sigurimi i cilësisë së produktit, si e dhënë në aneksin VI;

b) sigurimi i plotë i cilësisë, si e dhënë në aneksin VII;

c) konformiteti i tipit me kontroll rastësor për komponentët e sigurisë për ashensorë, si e dhënë në aneksin IX.

5. Numri i identifikimit i OM-së vendoset nga vetë OM-ja ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, ose nga instaluesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Markimi CE dhe numri i identifikimit i OM-së mund të pasohet nga ndonjë shenjë tjetër që tregon një risk ose përdorim të veçantë.

#### 19. Autoriteti i miratimit

Ministria përgjegjëse për tregtinë është autoriteti miratues për vlerësimin, regjistrimin dhe miratimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të regjistruara, duke përfshirë dhe përputhjen me pikën 22.

Më poshtë kjo ministri referohet si autoriteti i miratimit.

20. Kërkesat e degëve të organeve të notifikuara evropiane të regjistruara në Shqipëri për të operuar si organe të miratuara OM

#### 1. Për qëllime të miratimit si OM, një degë e e

një organi evropian (OEN), e regjistruar në Shqipëri, përveç kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 10489/2011, plotëson edhe kërkesat e dhëna në nënpikat 2 dhe 3 të kësaj pike.

2. Një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë një palë e tretë e pavarur nga organizata, ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorët që vlerëson.

Një organ që i përket një shoqate biznesi ose një federate profesionale që përfaqëson ndërmarrjet e përfshira në projektimin, prodhimin, montimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e ashensorëve ose komponentëve të sigurisë për ashensorë që ajo vlerëson, mund të konsiderohet si e pavarur nga ato, me kushtin që të demonstrohet pavarësia dhe mungesa e çdo konflikti të interesit.

3. Shpërblimi i nivelit më të lartë të administrimit dhe personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të organizatës vlerësimit të konformitetit nuk duhet të varet nga numri i vlerësimeve të kryera ose nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

21. Prezumimi i konformitetit i organeve të miratuar

Në rastin kur një organ i vlerësimit të konformitetit demonstron konformitetin e tij me kriteret e dhëna në standarde përkatëse të harmonizuara ose pjesë të tyre, referimet e të cilave janë pjesë e këtij rregulli teknik, ai prezumohet se përbush kërkesat e pikës 20 dhe nenit 19, të ligjit nr. 10489/2011, për aq sa këto standarde të harmonizuara mbulojnë ato kërkesa.

22. Filialët dhe nënkontraktimi nga organet e miratuar

1. Në rastin kur një organ i miratuar nënkontraktion detyra specifike të lidhura me vlerësimin e konformitetit ose ka rekurs në një filiali, ai siguron që nënkontraktori ose filiali përbushin kërkesat e pikës 20 të këtij rregulli teknik dhe të nenit 19, të ligjit nr. 10489/2011 dhe, në përputhje me rrëthanat, informon ministrinë për tregtinë si autoritet miratimi.

2. Organi i miratuar merr përgjegjësinë e plotë për të gjitha detyrat e kryera nga nënkontraktori ose filiali, pavarësish ku janë vendosur.

3. Aktivitetet e vlerësimit të konformitetit mund të nënkontraktohen vetëm në marrëveshje me klientin.

4. Organi i miratuar mban në dispozicion të

autoritetit të miratimit dokumentet që lidhen me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktorit ose filialit dhe punën e kryer nga ata sipas aneksit IV deri në aneksin XII.

### 23. Kërkesa për miratim

1. Një organ i vlerësimit të konformitetit paraqet një kërkesë për miratim në autoritetin e miratimit.

2. Kërkesa për miratim shoqërohet nga përshkrimi i aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit, procedura ose procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorë për të cilat ai pretendon të jetë kompetent, si dhe një certifikatë akreditimi të lëshuar nga një organ kombëtar akreditimi që dëshmon se organi i vlerësimit të konformitetit përbush kërkesat e përcaktuara në pikën 24 dhe në nenin 19 dhe 21, të ligjit nr. 10489/2011, të ndryshuar.

### 24. Procedura e miratimit

1. Ministri përgjegjës për tregtinë miraton OM-në që plotësojnë vetëm kërkesat e ligjit nr. 10489/2011, si dhe ato të parashikuara në pikën 20 të këtij rregulli teknik.

2. Miratimi duhet të përfshijë informacione të plota mbi aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, procedurën ose procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorët në fjalë dhe vlerësimet përkatëse të kompetencës.

25. Detyrimet operacionale të organeve të miratuara OM

1. Organet e miratuara kryejnë vlerësimet e konformitetit në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të dhëna në pikat 14 dhe 15.

2. Vlerësimet e konformitetit kryhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesa të panevojshme për operatorët ekonomikë. Organet e miratuara kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë në konsideratë madhësinë e ndërmarrjes, sektorin në të cilin operon, strukturën e saj, shkallën e kompleksitetit teknologjik të ashensorëve ose komponentëve të sigurisë për ashensorët në fjalë dhe masën ose natyrën seriale të procesit të prodhimit.

Ato duhet të respektojnë shkallën e ashpërsisë dhe nivelin e mbrojtjes së nevojshme për përputhshmërinë e ashensorëve ose komponentëve të sigurisë për ashensorë me këtë rregull teknik.

3. Në rastin kur një organ i miratuar konstaton se kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të përcaktuara në këtë rregull teknik apo standartet e harmonizuara, dokumentet normative ose specifikimeve të tjera teknike nuk janë plotësuar nga një instalues ose prodhues, organi i miratuar merr masat e duhura korrigjuese dhe nuk lëshon një certifikatë.

4. Në rastin kur në rrjedhën e monitorimit të konformitetit, pas lëshimit të një certifikate ose të një vendimi aprovimi, një organ i miratuar gjen se një ashensor ose një komponent i sigurisë për ashensorë nuk është në konformitet, ai i kërkon instaluesit ose prodhuesit të marrë masat e duhura korrigjuese dhe, nëse është e nevojshme, pezullon ose tërheq certifikatën.

5. Në rastin kur nuk janë marrë masat korrigjuese ose nuk kanë dhënë efektin e kërkuar, organi i miratuar, sipas rastit, kufizon, pezullon ose tërheq çdo certifikatë. Organet e miratuara duhet të kryejnë vlerësimet e konformitetit në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të dhëna në pikat 14 dhe 15.

26. Detyrimi i informacionit për organet e miratuara

1. Organet e miratuara informojnë autoritetin e miratimit për:

a) çdo refuzim, kufizim, pezullim ose heqje të një certifikate ose vendimi aprovimi;

b) çdo rrethanë që ndikon në qëllimin ose në kushtet për miratimin;

c) çdo kërkesë për informacion të cilin ata e kanë marrë nga ISHMT-ja në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

ç) në bazë të kërkesës, aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të kryera brenda fushës së zbatimit të miratimit të tyre dhe të çdo veprimtarie tjetër të kryer, duke përfshirë veprimtaritë dhe nënkontraktimet ndërkufitare.

2. Organet e miratuara u ofrojnë organeve të tjera të miratuara sipas këtij rregulli teknik, që kryejnë aktivitete të ngjashme të vlerësimit të konformitetit, që mbulojnë të njëjtë tipa për ashensorë ose të njëjtë komponentë të sigurisë për ashensorë, informacionin e duhur mbi çështje që lidhen me rezultatet negative, dhe, sipas kërkesës, rezultatet pozitive të vlerësimit të konformitetit.

27. Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i ashensorëve ose komponentëve të sigurisë për ashensorë që hyjnë në territorin shqiptar.

Mbikëqyrja e tregut e lidhur me kontrollin e ashensorëve dhe komponentëve të sigurisë për ashensorë kryhet sipas përcaktimeve në kreun VII, të ligjit nr. 10489/2011.

28. Procedura për trajtimin e ashensorëve ose komponentëve të sigurisë për ashensorë që paraqesin një risk në nivel kombëtar

1. Në rastin kur ISHMT-ja ka arsyte të mjaftueshme që të besojë se një ashensor ose komponent i sigurisë për ashensorë, i mbuluar nga ky rregull teknik, paraqet një risk lidhur me shëndetin dhe sigurinë e personave ose të sigurisë së pronës, ai kryen një vlerësim në lidhje me ashensorin ose komponentin e sigurisë për ashensorë që mbulon të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregull teknik. Operatorët përkatës ekonomikë duhet të bashkëpunojnë për këtë qëllim me ISHMT-në.

Në rastin kur gjatë vlerësimit të referuar në nënparagrafin e mësipërm, ISHMT-ja gjen se një ashensor nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik, ai pa vonesë kërkon nga instaluesi përkatës të ndërmarrë të gjitha veprimet e përshtatshme korrigjuese për të sjellë ashensorin në përputhje me kërkesat brenda një periudhe të arsyeshme, proporcionalisht me natyrën e riskut si ai e përshkruan.

Në rastin kur gjatë vlerësimit të përmendur në nënparagrafin e parë, ISHMT-ja gjen se një komponent i sigurisë për ashensorë nuk plotëson kërkesat e dhëna në këtë rregull teknik, ai pa vonesë i kërkon operatorit përkatës ekonomik të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese për të sjellë komponentin e sigurisë për ashensorë në përputhje me kërkesat, të térheqë komponentin e sigurisë për ashensorë nga tregu ose ta kufizojë atë brenda një periudhe të arsyeshme, proporcionalisht me natyrën e riskut siç e përshkruan ai.

ISHMT-ja informon menjëherë ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe organin e miratuar.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha masat e duhura korrigjuese në lidhje me të gjithë ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë në fjalë që ai i ka bërë të disponueshëm në tregun shqiptar.

3. Në rastin kur instaluesi nuk merr masat përkatëse korrigjuese brenda afatit të referuar në nënparagrafin e dytë, të nënpikës 1, ISHMT-ja merr të gjitha masat e duhura për ta ndaluar ose

për ta kufizuar vendosjen në treg ose përdorimin e ashensorit në fjalë, ta térheqë ose ta pezullojë atë.

Në rastin kur operatori ekonomik nuk merr masat përkatëse korrigjuese brenda periudhës kohore të referuar në nënparagrafin e tretë të pikës 1, ISHMT-ja merr të gjitha masat e duhura për ta ndaluar ose për ta kufizuar komponentin e sigurisë për ashensorët që të jetë i vlefshëm në tregun shqiptar ose ta pezullojë atë.

ISHMT-ja informon menjëherë ministrinë përgjegjëse për tregtinë.

4. Informacioni i referuar në nënparagrafin e tretë, të paragrafit të tretë, përfshin të gjitha hollësitë e vlefshme, vëcanërisht të dhënat e nevojshme për identifikimin e mospërputhjeve të ashensorit ose komponentit të sigurisë për ashensorët, origjinën e tyre, natyrën e mospërputhjes së pretenduar dhe riskun e përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra dhe argumentet e paraqitura nga operatorët përkatës ekonomikë. Në veçanti, ISHMT-ja tregon nëse mospërputhja është për shkak të njërit prej shkaqeve të mëposhtme:

a) defekt i ashensorit ose komponentit të sigurisë për ashensorë në mosplotësimin e kërkesave thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të përcaktuara në këtë rregull teknik; ose

b) mangësi në standartet e harmonizuara ose në dokumentet normative në dhënen e një prezumimi të konformitetit.

29. Ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorë që janë në konformitet dhe që paraqesin një risk

1. Në rastin kur është kryer një vlerësim sipas pikës 28.1, ISHMT-ja gjen se edhe pse një ashensor është në përputhje me këtë rregull teknik, ai paraqet një risk lidhur me shëndetin ose sigurinë e personave dhe ku kërkohet sigurinë e pronës, ai i kërkon instaluesit të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që ashensori të mos e paraqesë më atë risk, të ndalojë ashensorin ose ta térheqë atë nga përdorimi brenda një periudhe të arsyeshme, proporcionalisht me natyrën e riskut, sipas përshkrimit të tij.

Në rastin kur është kryer një vlerësim sipas pikës 28.1, ISHMT-ja gjen, se edhe pse një komponent i sigurisë për ashensorët është në përputhje me këtë rregull teknik, ai paraqet risk për shëndetin ose sigurinë e personave dhe, sipas rastit,

sigurinë e pronës, ai duhet të kërkojë nga operatori përkatës ekonomik të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që komponenti i sigurisë për ashensorët në fjalë, kur vendosen në treg, të mos paraqesë atë risk, për ta térhequr komponentin e sigurisë për ashensorë nga tregu, ose ta térheqë atë brenda një periudhe të arsyeshme, në përputhje me natyrën e rrezikut, sipas përshtimit të tij.

2. Operatori ekonomik siguron se është marrë veprimi korrigues në lidhje me të gjithë ashensorët ose komponentët e sigurisë për ashensorë në fjalë që ai i ka bërë të disponueshëm në treg.

### 30. Mospërputhje formale

1. Pa cenuar pikën 28, në rastin kur ISHMT-ja bën një nga gjetjet e mëposhtme, ai i kërkon operatorit përkatës ekonomik t'i japë fund mospërputhjes në fjalë:

- a) markimi CE është vendosur në kundërshtim me nenin 9, të ligjit 10489/2011 ose me kërkesat e këtij rregulli teknik;
- b) markimi CE nuk është vendosur;
- c) numri i identifikimit OM është i vendosur në kundërshtim me pikën 18 ose nuk është i vendosur në rastin kur kërkohet nga pika 18;
- c) deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar;
- d) deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar si duhet;

dh) dokumentacioni teknik, si i referuar në pjesën A dhe B të aneksit IV dhe në anekset VII, VIII dhe IX nuk është në dispozicion apo është jo i plotë.

e) emri, emri tregtar i regjistruar ose marka tregtare e regjistruar ose adresa e instaluesit, prodhuesit ose importuesit nuk është treguar në përputhje me pikat 7.6 dhe 8.5 të këtij rregulli teknik dhe nenit 12.3, të ligjit 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar;

ë) informacioni që lejon identifikimin e ashensorit ose komponentin e sigurisë për ashensorë nuk është treguar në përputhje me pikat 7.5 ose 8.4;

f) ashensori ose komponenti i sigurisë për ashensorë nuk është i shoqëruar nga dokumentet e referuara në pikat 7.7 ose 8.6 ose këto dokumente nuk janë në përputhje me kërkesat e zbatuara.

2. Në rastin kur mospërputhja e referuar në nënpikën 1 të kësaj pike vazhdon, ISHMT-ja merr

të gjitha masat e duhura për ta kufizuar ose për ta ndaluar përdorimin e ashensorit ose për ta pezulluar atë, ose për ta kufizuar ose për ta ndaluar vënien në dispozicion në treg të komponentit të sigurisë për ashensorë ose të sigurojë se ai është pezulluar ose térhequr nga tregu.

## ANEKSI I

### KËRKESAT THELBËSORE PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË

#### 1. Vërejtje paraprake

1. Detyrimet e lidhura me kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë zbatohen vetëm në rastin kur ekziston një risk për ashensorë ose komponentët e sigurisë për ashensorë kur përdoren si është parashikuar nga instaluesi ose prodhuesi.

2. Kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në këtë rregull teknik janë të detyrueshme. Megjithatë, duke pasur parasysh nivelin e teknologjisë, objektivat që ato jepin mund të janë të paarritshme. Në këto raste, për aq sa mundësohen, ashensori ose komponentët e sigurisë për ashensorë projektohen dhe konstruktohen në mënyrë të tillë që të përafrojnë sa më shumë këta objektiva.

3. Prodhesi dhe instaluesi janë të detyruar të kryejnë një vlerësim të riskut me qëllim që të identifikojnë të gjitha risqet, të cilat ndikojnë në produktet e tyre. Ata, pas kësaj, duhet të projektojnë dhe të konstrukojnë ato duke marrë parasysh vlerësimin e riskut.

#### 2. Të përgjithshme

##### 2.1. Zbatimi i rregullit teknik mbi makineritë

Në rastin kur ekziston një risk dhe nuk është trajtuar në këtë aneks, zbatohen kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë, të dhëna në pikën 14, të vendimit nr. 1060, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara". Zbatohen në çdo rast kërkesat e shprehura në pikën 14, shkronja "b" të këtij rregulli teknik.

##### 2.2. Platforma ngritëse

Platforma ngritëse duhet të jetë një kabinë. Kabinë projektohet dhe konstruktoret për të ofruar hapësirë dhe fortësi që i korrespondon numrit maksimal të njerëzve dhe ngarkesës nominale të ashensorit të vendosura nga instaluesi.

Në rastin e ashensorëve të parashikuar për

transportin e njerëzve dhe ku përmasat e lejojnë kabina projektohet dhe konstruktuhet në atë mënyrë që veçoritë strukturore të saj të mos pengojnë ose ndalojnë hyrjen dhe përdorimin nga njerëz me aftësi të kufizuara dhe të lejojë çdo rregullim të përshtatshëm që të lehtësohet përdorimi i saj prej tyre.

### 2.3. Mjetet e varjes dhe mjetet e mbështetjes

Mjetet e varjes dhe/ose mbështetjes së kabinës, kapjet e saj dhe pjesët fundore përzgjidhen dhe projektohen, si për të siguruar një nivel të mjafthueshëm të sigurisë së përgjithshme, ashtu dhe për të minimizuar rrezikun e rënies së kabinës duke marrë parasysh kushtet e përdorimit, materialet e përdorura dhe kushtet e prodhimit.

Në rastin kur përdoren litarë ose zinxhirë, për të varur kabinën duhet të jenë të paktën dy litarë ose zinxhirë të pavarur dhe secili të ketë sistemin e tij të ankorimit. Litarë dhe zinxhirë të tillë nuk duhet të kenë bashkime ose lidhje, me përjashtim të rastit kur është e domosdoshme përfshirë fiksimin ose përfshirë formimin e një laku.

### 2.4. Kontrolli i ngarkesës (duke përfshirë mbishpejtësinë)

2.4.1. Ashensorët projektohen, konstruktuhet dhe instalohen në mënyrë të tillë që të parandalohet nisja e tyre nëse tejkalohet ngarkesa nominale në to.

2.4.2. Ashensorët pajisen me një rregullues/kufizues mbishpejtësie.

Këto kërkesa nuk zbatohen përfshirë ashensorët në rastin kur projektimi i sistemit të drejtimit parandalon mbishpejtësinë.

2.4.3. Ashensorët e shpejtë pajisen me një pajisje që monitoron shpejtësinë dhe e kufizon atë.

2.4.4. Ashensorët e vënë në lëvizje me pulexho me fërkim projektohen që të sigurojnë qëndrueshmëri të litarëve tërheqës mbi pulexho.

### 2.5. Agregati i lëvizjes

2.5.1 Të gjithë ashensorët përfshirë pasagjerë kanë aggregatin e tyre individual të lëvizjes. Kjo kërkesë nuk zbatohet përfshirë ashensorët ku kundërpeshat zëvendësohen nga një kabinë e dytë.

2.5.2. Instaluesi siguron që të mos mundësohet hyrja tek aggregati i lëvizjes dhe në pajisjet shoqëruarë të një ashensori, përvëç rasteve të mirëmbajtjes dhe emergencës.

### 2.6. Sistemi i komandim-kontrollit

2.6.1. Sistemet e komandim-kontrollit të ashensorëve të parashikuara përfshirë përdorim nga njerëz me aftësi të kufizuara dhe të pashoqëruar,

projektohen dhe vendosen duke marrë parasysh këto rrrethana.

2.6.2. Funksioni i komandave të tregohet qartësisht.

2.6.3. Qarqet e kërkimit të një grupei ashensorësh të jenë të ndara ose të lidhura reciproksht.

2.6.4. Pajisjet elektrike instalohen dhe lidhen në mënyrë të tillë që:

a) të mos mundësohet që ato të ngatërrohen me qarqe që nuk kanë lidhje direkte me ashensorin;

b) furnizimi i energjisë mund të ndërpritet ndërsa është mbi ngarkesë;

c) lëvizjet e ashensorit varen nga pajisjet elektrike të sigurisë në një qark elektrik të sigurisë të ndarë;

ç) një defekt në instalimin elektrik të mos provokojë një situatë të rrezikshme.

### 3. Risqe përfshirë ashensorët

3.1. Ashensori projektohet dhe konstruktuhet që të sigurojë pengimin e hyrjes në hapësirën (kolonën) në të cilën lëviz kabina, me përjashtim të rasteve të mirëmbajtjes ose të emergjencave. Përpara se një person të hyjë në këtë hapësirë duhet të mos mundësohet përdorimi normal i ashensorit.

3.2. Ashensori projektohet dhe konstruktuhet përfshirë parandaluar riskun e përplasjes, kur kabina është në një nga pozicionet e saj ekstreme.

Kjo realizohet duke lënë një hapësirë ose një volum të lirë përtëj pozitioneve ekstreme të korsës normale të kabinës.

Megjithatë, në raste të veçanta, veçanërisht në ndërtesat ekzistuese ku kjo zgjidhje nuk plotësohet, parashikohen mënyra të tjera përfshirë këtë rrezik.

Arkitektët, inxhinierët, organet e autorizuara dhe instaluesit janë ligjërisht të detyruar të kërkojnë aprosim nga ministria, në rastet kur kërkojnë të certifikojnë ose të instalojnë një ashensor të ri pa hapësirën e lirë në pozicionet ekstreme. Në këto raste të jashtëzakonshme, duhet të hartohet një raport vlerësimi me mbështetjen e verifikuar edhe të organit të autorizuar përkatës, që dorëzohet në ministri, duke i dhënë mundësi asaj që të vlerësojë pamundësinë e instalimit të një ashensori “normal” me hapësirat e lira në pozicionet ekstreme.

3.3. Sheshpushimet në hyrje dhe në dalje të kabinës pajisen me dyer me një qëndrueshmëri të mjafthueshme mekanike në lidhje me kushtet e përcaktuara të përdorimit.

Gjatë përdorimit normal, një pajisje bllokuese parandalon:

a) vënien në lëvizje, me ose pa qëllim, të kabinës nëse dyert në shespushim nuk janë mbyllur dhe bllokuar;

b) hapjen e një dere në shespushim kur kabina është akoma duke lëvizur dhe është jashtë një zone shespushimi të parashikuar.

Megjithatë, të gjitha lëvizjet me dyer të hapura në shespushim lejohen vetëm në zona të veçanta me kushtin që niveli i shpejtësisë të jetë i kontrolluar.

#### 4. Risqe për njerëzit brenda në kabinë

4.1. Kabina e ashensorit duhet të jetë plotësish e mbyllur nga mure në të gjithë gjatësinë e saj, duke përfshirë dyert në të gjithë gjatësinë e saj, dysheme dhe tavan të përshtatshëm, me përjashtim të hapjeve të ventilimit. Dyert projektohen dhe instalohen që kabina të mos lëvizë nëse ato nuk janë mbyllur, duke përjashtuar lëvizjet në shespushim si e referuar në pikën 3.3 të këtij aneksi dhe ndalet në vendqëndrim nëse dyert janë të hapura.

Dyert e kabinës mbeten të mbyllura dhe të bllokuara nëse ashensori ndalon ndërmjet dy niveleve (kateve) dhe atje ka një rrezik rënieje midis kabinës dhe pareteve mbrojtëse nga boshllëku ose kur nuk ka fare parete të tillë mbrojtëse.

4.2. Në rastin e një ndërprerjeje të energjisë ose dëmtimi të komponentëve, ashensori duhet të ketë pajisje që parandalojnë rënien e lirë ose lëvizjet e pakontrolluara ngritëse të kabinës.

Pajisja që parandalon rënien e lirë duhet të jetë e pavarur nga elementet e varjes së kabinës.

Kjo pajisje mundëson ndalimin e kabinës në ngarkesën e përcaktuar dhe në shpejtësinë maksimale të parashikuar nga instaluesi. Çdo ndalim i shkaktuar nga kjo pajisje, në çfarëdo kushtesh të ngarkesës, nuk duhet të provokojë një ngadalësim të tillë që do të dëmtonte njerëzit në kabinë.

4.3. Ndërmjet pjesës fundore të hapësirës ku lëviz ashensori dhe dyshemesë së kabinës duhet të instalohen amortizatorë.

Në këtë rast, hapësira e lirë, si i referuar në nënpikën 3.2, llogaritet me amortizatorët plotësish të ngjeshur.

Kjo kërkesë nuk zbatohet në ata ashensorë ku, për kabinet e tyre, projekt i sistemit të drejtimit

nuk mund të sigurojë hapësirën e lirë si e referuar në pikën 3.2 të këtij aneksi.

4.4. Ashensorët projektohen dhe konstruktohen në mënyrë të tillë që të shhangin vënien në lëvizje të tyre nëse pajisja e parashikuar në pikën 4.2 të këtij aneksi nuk është në gjendje pune.

#### 5. Risqe të tjera

5.1. Në rastin kur dyert në shespushim dhe dyert e kabinës, ose së bashku, janë të motorizuara, ato përshtaten me një pajisje që parandalon rrezikun e përplasjes kur ato janë në lëvizje.

5.2. Në rastin kur dyert në shespushim, duke përfshirë dhe ato me pjesë xhami, ndihmojnë në mbrojtjen e ndërtëses ndaj zjarrit, ato duhet të jenë të qëndrueshme ndaj zjarrit në aspektet e integritetit dhe veticë të tyre në lidhje me materialet e izolimit (mbajtjen e flakëve) dhe transmetimin e nxehësisë (rrezatimi termik).

5.3. Kundërpeshat instalohen që të shhangin çdo risk nga goditjet ose nga rëniet e tyre mbi kabinë.

5.4. Ashensorët pajisen me mjete që t'u japid mundësi njerëzve të bllokuar në kabinë të çlironë dhe të shpërngulen.

5.5. Kabinave u sigurohen dy mënyra komunikimi që lejojnë kontakt të përhershëm me shërbimin e shpëtimit.

5.6. Ashensorët projektohen dhe konstruktohen në mënyrë të tillë që në rastin kur temperatura në pajisjen ngritëse kalon vlerën maksimale të përcaktuar nga instaluesi, ato mundësojnë përfundimin e lëvizjes në progres, por refuzojnë komandat e reja.

5.7. Kabinet projektohen dhe konstruktohen që të sigurojnë një ventilim të mjaftueshmërisht e pasagjerët edhe në rastin e një ndalimi të zgjatur.

5.8. Kabina duhet të jetë mjaftueshmërisht e ndriçuar si gjatë përdorimit, ashtu dhe kur hapet një derë. Gjithashtu duhet të ketë edhe ndriçimin emergjent.

5.9. Mënyra e komunikimit, si e referuar në nënpikën 5.5 të kësaj pike dhe ndriçimi emergjent, siç referohet në nënpikën 5.8, projektohen dhe konstruktohen që të funksionojnë edhe pa furnizim normal të energjisë. Koha e funksionimit të tyre duhet të jetë aq e gjatë sa të lejojë funksionimin normal të procedurës së shpëtimit.

5.10. Qarqet e komandimit të ashensorëve që mund të përdoren në raste zjarri, projektohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që ashensori të mund

të parandalohet nga ndalimi në kate të caktuara dhe që të lejojë përparësinë e kontrollit të ashensorit nga ekipi i shpëtimit.

## 6. Markimi

6.1. Përveç të dhënave minimale të kërkua të çdo makineri të përcaktuar në pikën 14.1.7.3, të vendimit nr. 1060, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik, "Për makineritë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara",", çdo kabinë mban në mënyrë të quartë dhe të dukshme pllakatin që tregon ngarkesën nominale të ushtruar, vlerësuar në kilogram dhe numrin maksimal të njerëzve që mund të mbajë.

6.2. Nëse ashensori projektohet në mënyrë të tillë që njerëzit e bllokuan brenda në kabinë të mund të çliron, pa ndihmë nga jashtë, instrukzionet përkatëse duhet të jenë të qarta dhe të dukshme në kabinë.

## 7. Instruksionet

7.1. Komponentët e sigurisë për ashensorë, të referuar në aneksin III, shoqërohen nga instruksionet, në mënyrë që të mund të kryhet saktë dhe pa rrezik:

- a) montimi;
- b) lidhja;
- c) rregullimi;
- ç) mirëmbajtja.

7.2. Çdo ashensor shoqërohet nga instruksionet. Instruksionet përbajnjë së paku dokumentet e mëposhtme:

a) instruksionet që përbajnjë vizatimet e punës dhe diagramet e nevojshme për përdorim normal, si dhe instruksionet që lidhen me mirëmbajtjen, inspektimin, riparimin, kontrolllet periodike dhe funksionet e shpëtimit, si të referuar në paragrapin 5.4 të këtij aneksi.

b) një regjistër në të cilin evidentohen riparimet dhe, sipas rastit, edhe kontrolllet periodike.

## ANEKSI II

A. Përbajtja e deklaratës së konformitetit për komponentët e sigurisë për ashensorë

Deklarata EU e konformitetit për komponentët e sigurisë për ashensorë përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e biznesit dhe adresën e prodhuesit;
- b) sipas rastit, emrin e biznesit dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar;

c) përshkrimin e komponentit të sigurisë për ashensorë, detaje të tipit ose serive dhe numrin serial (nëse ka), si dhe përfshihet një pamje, kur është e nevojshme, për identifikimin e komponentit të sigurisë për ashensorë;

ç) funksionin e sigurisë të komponentit të sigurisë për ashensorë, nëse nuk është i qartë nga përshkrimi,

d) vitin e prodhimit të komponentit të sigurisë për ashensorë;

dh) të gjitha dispozitat përkatëse që plotëson komponenti i sigurisë për ashensorë;

e) një deklarim se komponenti i sigurisë për ashensorë është në konformitet me legjisacionin e harmonizuar;

ë) sipas rastit, referimet e standardeve të harmonizuara të përdorura;

f) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së, i cili ka kryer shqyrtimin EC të tipit të komponentëve të sigurisë për ashensorë, të dhënë në pjesën A tek aneksi IV dhe aneksi VI dhe referimin e certifikatës së shqyrtimit të lëshuar nga OM-ja;

g) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së që ka kryer konformitetin e tipit me kontrollë rastësore për komponentët e sigurisë për ashensorë, si të dhënë në aneksin IX;

gj) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së, i cili ka aprovuar sistemin e cilësisë të operuar nga prodhuesi në përputhje me procedurën e vlerësimit të konformitetit, të dhënë në aneksin VI ose VII;

h) emrin dhe funksionin e personit të autorizuar për të nënshkruar deklaratën në emër të prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar;

i) vendin dhe datën e firmosjes;

j) firmën.

B. Përbajtja e deklaratës EU të konformitetit për ashensorët

Deklarata EC e konformitetit për ashensorë hartoherë në shqip dhe përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e biznesit dhe adresën e instaluesit;

b) në rastin kur kërkohet, emrin e biznesit dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar;

c) përshkrimin e ashensorit, detaje mbi tipin ose seritë, numrin serial dhe adresën ku instalohet ashensori;

ç) vitin e instalimit të ashensorit;

d) të gjitha dispozitat përkatëse me të cilat ashensori është në konformitet;

dh) një deklaratë që ashensori është në konformitet me legjislacionin përkatës të harmonizuar;

e) sipas rastit, referimet e standardeve të harmonizuara të përdorura;

ë) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së që ka kryer shqyrtimin EU të tipit, si të referuar në pjesën B të aneksit IV dhe referimin e certifikatës së shqyrtimit EU të tipit të lëshuar nga OM-ja;

f) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së që ka kryer verifikimin e njësisë për ashensorë, si të dhënë në aneksin VIII;

g) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së që ka kryer inspekrimin përfundimtar të ashensorit, si të referuar në aneksin V;

gj) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të OM-së që ka aprovuar sistemin e sigurimit të cilësisë së operuar nga instaluesi i ashensorit në përputhje me procedurën e vlerësimit të konformitetit, si të dhënë në aneksin X, XI ose XII;

h) emrin dhe funksionin e personit që firmos deklaratën në emër të instaluesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;

i) vendin dhe datën e firmosjes;

j) firmën.

### ANEKSI III

#### LISTA E KOMPONENTËVE TË SIGURISË PËR ASHENSORË

1. Pajisje për mbylljen e dyerve në sheshpushim.

2. Pajisje për parandalimin e rënieve, si e referuar në pikën 4.2 të aneksit I, për të parandaluar kabinën nga rënia ose nga lëvizjet e pakontrolluara ngritëse.

3. Pajisjet për kufizimin e mbishpejtësisë.

4. a) amortizatorët për akumulimin e goditjes:

i) jolinear; ose

ii) me amortizim të lëvizjes së kthimit.

b) amortizator për shpërndarjen e goditjes.

5. Pajisjet e sigurisë të përshtatura për krikë hidraulike kur ato përdoren si pajisje për të parandaluar rënien.

6. Pajisjet elektrike të sigurisë në formën e çelësave të sigurisë që përbajnë komponentë elektronikë.

### ANEKSI IV

#### SHQYRTIMI EU I TIPIT PËR ASHENSORË DHE KOMPONENTË TË SIGURISË PËR ASHENSORË (MODULI B)

A. Shqyrtimi EU i tipit për komponentët e sigurisë për ashensorë

1. Shqyrtimi EC i tipit është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit nëpërmjet së cilës një OM shqyrton projektin teknik të një komponenti të sigurisë për ashensorë dhe verifikon dhe vlerëson se projektin teknik i komponentit të sigurisë për ashensorë plotëson kërkesat thelbësore të zbatuara të shëndetit dhe të sigurisë të aneksit I dhe mundëson në një ashensor në të cilin është montuar korrektësisht të plotësojë këto kërkesa.

2. Kërkesa për shqyrtimin EC të tipit paraqitet nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar vetëm në një OM të zgjedhur nga ai vetë. Kërkesa përban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin e tij dhe adresën, si dhe vendin e prodhimit të komponentit të sigurisë për ashensorë;

b) një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur në një tjetër OM;

c) dokumentacionin teknik;

ç) një mostër përfaqësuese të komponentit të sigurisë për ashensorë ose detajime të vendit ku ai mund të shqyrtohet. OM-ja mund të kërkojë mostra të tjera, nëse kërkohen për kryerjen e programit të testimit;

d) dëshminë mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse duhet të përmendë çdo dokument, duke përfshirë specifikimet e përkatëse teknike, të cilat janë përdorur, veçanërisht në rastin kur nuk janë zbatuar tërësisht standardeve të harmonizuara. Dëshmia mbështetëse përfshin, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet teknike nga laboratori përkatës i prodhuesit ose nga një laborator tjetër testimi në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

3. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë të vlerësojë nëse komponenti i sigurisë për ashensorë plotëson kushtet e referuara në nënpikën 1 të këtij aneksi dhe përfshin një analizë të përshtatshme dhe vlerësim të riskut/qeve. Dokumentacioni teknik përcakton kërkesat e zbatuara dhe mbulon, aq sa kërkohet për vlerësim, projektin e prodhimit dhe funksionimin e komponentit të sigurisë për ashensorë.

Dokumentacioni teknik, në rastin kur kërkohet, përmban si më poshtë vijon:

a) një përshkrim të komponentit të sigurisë për ashensorë, duke përfshirë fushën e tij të përdorimit (veçanërisht kufijtë e mundshëm për shpejtësinë, ngritjen dhe fuqinë) dhe kushtet (veçanërisht ambientet me rrezik shpërthimi dhe ekspozimin ndaj elementeve);

b) vizatime pune ose diagrame projektimi dhe prodhimi;

c) shpjegimet e nevojshme për kuptimin e këtyre vizatimeve dhe diagrameve dhe funksionimin e komponentit të sigurisë për ashensorë;

ç) një listë të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referimet e të cilave janë pjesë e këtij rregulli teknik dhe në rastin kur këto standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të mundësuar komponentët e sigurisë për ashensorë të plotësijnë kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi, duke përfshirë një listë të specifikimeve teknike të zbatuara. Në rastin e përdorimit të pjesshëm të një standardi të harmonizuar, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar;

d) rezultatet e llogaritjeve të projektit, të kryera nga ose për prodhuesin;

dh) raportet e testimit;

e) një kopje të instruksioneve për komponentët e sigurisë për ashensorë;

ë) hapat e ndërmarrë në procesin e prodhimit që sigurojnë se seriti e prodhuara të komponentëve të sigurisë për ashensorë janë në përputhje me komponentin e sigurisë për ashensorë të shqyrtuar.

4. OM-ja duhet:

a) të shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe dëshminë mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmérinë e projektit teknik të komponentit të sigurisë për ashensorë;

b) të bjerë dakord me aplikantin për vendin ku do të kryhen shqyrtimet dhe testet;

c) të verifikojë që mostra/t përfaqësuese është/janë prodhuar në konformitet me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë elementet që janë projektuar sipas dispozitave të zbatuara të standardeve të harmonizuara, si dhe po ashtu elementet që janë projektuar sipas specifikimeve teknike;

c) të kryejë shqyrtimet dhe testet përkatëse ose të detyrojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse, në rastin kur prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë specifikimet e standardeve përkatëse të harmonizuara, këto janë zbatuar korrektsisht;

d) të kryejë shqyrtimet dhe testet përkatëse ose të detyrojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar, në rastin kur specifikimet e standardeve përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar, nëse zgjidhjet e përshtatura nga prodhuesi, duke zbatuar specifikime teknike përkatëse, mundësijnë që komponenti i sigurisë për ashensorë të plotësijoë kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi.

OM-ja harton një raport vlerësimi që regjistron shqyrtimet, verifikimet dhe testet e kryera dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e tij ndaj autoritetit të miratimit, OM-ja shpërndan përbajtjen e këtij raporti, në tërësi ose pjesërisht, vetëm me pëlqimin e prodhuesit.

5. Në rastin kur tipi i komponentit të sigurisë për ashensorë plotëson kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi, OM-ja lëshon për prodhuesit një certifikatë EU të shqyrtimit të tipit. Kjo certifikatë përmban emrin dhe adresën e prodhuesit konkluzionet e shqyrtimit EU të tipit, të gjitha kushtet e vlefshmërisë së certifikatës dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të miratuar.

Certifikata e shqyrtimit EU të tipit mund të ketë një ose më shumë anekse të bashkëngjitura.

Certifikata e shqyrtimit EU të tipit dhe anekset e saj përbajnjë të gjithë informacionin përkatës që lejon konformitetin e komponentëve të sigurisë për ashensorë të prodhuara me tipin e vlerësuar dhe lejon kontrollin në shërbim.

Në rastin kur tipi i komponentit të sigurisë për ashensorë nuk përbush kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi, OM refuzon lëshimin e certifikatës së shqyrtimit EU të tipit dhe informon menjëherë aplikantin duke i dhënë arsyet e detajuara të refuzimit.

Për një periudhë 15-vjeçare nga data e lëshimit të kësaj certifikate, OM-ja mban një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit, anekset dhe shtesat e saj, si dhe dokumentacionin teknik dhe raportin e vlerësimit.

6. OM-ja duhet të jetë e informuar për çdo ndryshim në gjendjen përgjithësisht të pranuar të teknologjisë të cilat tregojnë se tipi i miratuar mund të mos plotësojë kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi dhe përcakton nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse është kështu, OM-ja informon prodhuesin në përputhje me rrethanat.

7. Prodhesi informon OM-në që mban dokumentacionin teknik lidhur me certifikatën e shqyrtimit EU të tipit për çdo ndryshim në tipin e miratuar që mund të ndikojë në konformitetin e komponentit të sigurisë për ashensorë lidhur me kushtet e përmendura në pikën 1 të këtij aneksi ose me kushtet e vlefshmërisë së certifikatës të shqyrtimit EU të tipit.

OM-ja shqyrton ndryshimin dhe informon aplikantin nëse certifikata e shqyrtimit EU të tipit të mbetet e vlefshme ose nëse kërkohen shqyrtimi, verifikime ose testime të tjera. Sipas rastit, OM-ja lëshon një shtesë në certifikatën origjinale të shqyrtimit EU të tipit ose kërkon të dorëzohet një aplikim i ri për një shqyrtim EU të tipit.

8. Çdo OM informon autoritetin e miratimit në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe të çdo shtese të saj që i ka lëshuar ose tërhequr dhe në mënyrë periodike ose në bazë të kërkësës, vë në dispozicion për autoritetin e miratimit listën e këtyre certifikatave dhe të shtesave të refuzuara, të pezulluara ose të kufizuara.

Çdo OM informon OM-të e tjera në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe të çdo shtese që ai e ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkësës, në lidhje me certifikatat dhe/ose shtesave të tilla që i ka lëshuar.

9. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, prodhesi mban me dokumentacionin teknik dhe një kopje të certifikatave të shqyrtimit EU të tipit, anekset dhe shtesat e saj në dispozicion të ISSHMT-së.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën e referuar në pikën 2 të këtij aneksi dhe të përbushë detyrimet e dhëna në pikat 7 dhe 10 të këtij aneksi, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

#### B. Shqyrtimi EU i tipit për ashensorë

1. Shqyrtimi EU i tipit për ashensorë është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit në të cilën një OM shqyrton projektin teknik të një ashensori model ose të një ashensori për të cilin nuk ka asnjë dispozitë për një shtrirje ose variant dhe verifikon dhe vlerëson që projekti teknik i modelit të ashensorit ose ashensori plotëson kërkësat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

Shqyrtimi EU i tipit i një ashensori përfshin një shqyrtim të një mostre përfaqësuese si një ashensor komplet.

2. Kërkesa për shqyrtimin EU të tipit paraqitet nga instaluesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vetëm në një OM sipas zgjedhjes së tij.

#### Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e instaluesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkësë nuk është paraqitur në një OM tjeter;

c) dokumentacionin teknik,

ç) detaje të vendit ku mostra e ashensorit mund të shqyrtohet.

Mostra e ashensorit e dorëzuar për shqyrtim, përfshin pjesët terminale dhe duhet të jetë në gjendje shërbimi në të paktën tri nivele (i lartë, i mesem dhe poshtë);

d) dëshminë mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse përmend çdo dokument, duke përfshirë specifikimet përkatëse teknike që janë përdorur, veçanërisht në rastet kur nuk janë zbatuar plotësisht standarde e harmonizuara. Dëshmia mbështetëse përfshin, në rastin kur kërkohet, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet përkatëse teknike nga laboratori i instaluesit ose nga një tjeter laboratori testimi, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij.

3. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë që ai të vlerësojë konformitetin e ashensorit me kërkësat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I.

Dokumentacioni teknik përmban kur është e zbatueshme sa më poshtë:

a) një përshkrim të modelit të ashensorit, duke treguar qartësisht të gjitha variantet e lejuara të modelit të ashensorit;

b) vizatime dhe diagrame të prodhimit;

c) shpjegime të nevojshme për kuptimin e këtyre vizatimeve dhe diagrameve dhe funksionimin e ashensorit;

c) një listë të kërkesave thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë që janë marrë parasysh;

d) një listë të standardeve të harmonizuara, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referimet e të cilave janë pjesë e këtij rregulli teknik dhe në rastin kur këto standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë së këtij rregulli teknik, duke përfshirë një listë të specifikimeve përkatëse teknike të zbatuara. Në rastin e standardeve të harmonizuara, të zbatuara pjesërisht, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar;

dh) një kopje të deklaratave EU të konformitetit të komponentëve të sigurisë për ashensorë të montuar në ashensor;

e) rezultatet e llogaritjeve të projektit, të kryera nga ose për instaluesin;

ë) raportet e testimit;

f) një kopje të instruksioneve të referuara në pikën 7.2 të aneksit I;

g) hapat e marrë gjatë instalimit për të siguruar që seritë e produhuara të ashensorit janë konform me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

4. OM-ja duhet:

a) të shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe dëshminë mbështetëse për të vlerësuar përshtatjen e projektit teknik të modelit të ashensorit për të cilin nuk ka dispozitë për një vazhdimësi ose variant;

b) të bjerë dakord me instaluesin mbi vendin ku do të kryhen shqyrtimet dhe testet;

c) të shqyrtojë mostrën e ashensorit për të kontrolluar që ajo është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë elementet të cilat janë projektuar në përputhje me dispozitat e zbatuara të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe të elementeve që janë projektuar në përputhje me specifikimet përkatëse teknike;

c) të kryejë shqyrtimet dhe testet përkatëse ose të detyrojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse, në rastin kur instaluesi ka zgjedhur të zbatojë specifikimet e standardeve përkatëse të harmonizuara, ato janë zbatuar korrektësisht;

d) të kryejë shqyrtimet dhe testet përkatëse ose të detyrojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse, në rastin kur specifikimet e standardeve të harmonizuara nuk janë zbatuar, zgjidhjet e përshtatura nga instaluesi duke zbatuar specifikimet përkatëse teknike plotësojnë kërkesat korresponduese thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të këtij rregulli teknik.

5. OM-ja harton një raport vlerësimi që regjistron shqyrtimet, verifikimet dhe testimet e kryera dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimin e tij ndaj autoritetit të miratimit, OM-ja jep përbajtjen e këtij raporti plotësisht apo pjesërisht vetëm në marrëveshje me instaluesin.

6. Në rastin kur tipi plotëson kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I, të zbatuara në ashensorin në fjalë, OM-ja lëshon për instaluesin një certifikatë të shqyrtimit EU të tipit.

Kjo certifikatë përmban emrin dhe adresën e instaluesit, konkluzionet e shqyrtimit EU të tipit, kushtet e vlefshmërisë së certifikatës dhe të dhënat e nevojshme për të identifikuar tipin e aprovuar.

Certifikata e shqyrtimit EU e tipit mund të ketë një ose më shumë anekse të bashkëngjitura.

Certifikata e shqyrtimit EU e tipit dhe anekset e saj përbajnjë të gjithë informacionin e nevojshëm për të mundësuar konformitetin e ashensorëve me tipin e aprovuar, të vlerësuar gjatë inspektimit përfundimtar.

Në rastin kur tipi nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I, OM-ja refuzon lëshimin e certifikatës të shqyrtimit EU të tipit dhe informon për këtë instaluesin, duke dhënë arsyet e detajuara për refuzimin e tij.

Për një periudhë 15-vjeçare nga data e lëshimit të kësaj certifikatë, OM-ja mban një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit, anekset dhe shtesat e saj, si dhe dokumentacionin teknik dhe raportin e vlerësimit.

7. OM-ja duhet të jetë e informuar për çdo ndryshim në gjendjen përgjithësisht të pranuar të teknologjisë, që tregojnë se tipi i miratuar mund

të mos plotësojë më kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I dhe duhet të përcaktojë nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse është kështu, OM informon instaluesin në përputhje me rrrethanat.

8. Instaluesi informon OM-në për çdo ndryshim në tipin e aprovuar, duke përfshirë ndryshime jo të specifikuara në dokumentacionin origjinal teknik, të cilat mund të ndikojnë në konformitetin e ashensorit lidhur me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I ose të kushteve të vlefshmërisë të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit.

OM-ja shqyrtton ndryshimin dhe informon instaluesin nëse certifikata e shqyrtimit EU të tipit është e vlefshme ose nëse janë të nevojshme shqyrtime, verifikime dhe teste të tjera. Sipas rastit, OM-ja lëshon një shtesë në certifikatën originale të shqyrtimit EU të tipit ose kërkon të dorëzohet një kërkesë e re për një shqyrtim EU të tipit.

9. Çdo OM informon autoritetin e miratimit në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe të çdo shtese të saj që i ka lëshuar ose térhequr dhe periodikisht ose në bazë të kërkesës, vë në dispozicion për autoritetin e miratimit listën e këtyre certifikatave dhe të shtesave të refuzuara, të pezulluara ose të kufizuara.

Çdo OM informon OM e tjera në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe të çdo shtese që e ka refuzuar, térhequr, pezulluar ose kufizuar dhe sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat dhe/ose shtesave të tillë të saj që i ka lëshuar.

10. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, instaluesi mban me dokumentacionin teknik një kopje të certifikatave të shqyrtimit EU të tipit dhe anekset e saj në dispozicion të ISHMT-së.

11. Përfaqësuesi i autorizuar i instaluesit mund të paraqesë kërkesën e referuar në pikën 2 të këtij aneksi dhe të përbushë detyrimet e dhëna në pikat 8 dhe 10 të këtij aneksi, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

## ANEKSI V

### 1. Inspektimi përfundimtar për ashensorë

Inspektimi përfundimtar është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM konstaton dhe vërteton se një ashensor që është subjekt i një certifikate të shqyrtimit EU të tipit ose i projektuar dhe i prodhuar në bazë të një sistemi të miratuar të cilësisë, plotëson kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

### 2. Detyrimet e instaluesit

Instaluesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se ashensori në instalim plotëson kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I dhe një nga kërkesat e mëposhtme:

a) një tip i aprovuar, i përshkruar në një certifikatë të shqyrtimit EU të tipit;

b) një ashensor i projektuar dhe prodhuar në përputhje me një sistem të cilësisë duke marrë parasysh aneksin XI dhe certifikatën e shqyrtimit EU të projektit nëse projekti nuk është plotësish në përputhje me standardet e harmonizuara.

### 3. Inspektimi përfundimtar

Një OM e zgjedhur nga instaluesi kryen inspektimin përfundimtar të ashensorit lidhur me vendosjen në treg, për të kontrolluar konformitetin e ashensorit me kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

3.1. Instaluesi paraqet një kërkesë për inspektimin përfundimtar vetëm në një OM me zgjedhje të tij dhe siguron për OM-në dokumentet e mëposhtme:

a) planin e ashensorit komplet;

b) planet dhe diagramet e nevojshme për inspektimin përfundimtar, veçanërisht diagramet e qarkut të kontrollit;

c) një kopje të instruksioneve të referuara në pikën 7.2 të aneksit I;

ç) një deklaratë me shkrim se e njëjtë kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjeter.

OM-ja mund të mos kërkojë plane të detajuara ose informacion të përcaktuar jo të nevojshëm për verifikimin e konformitetit të ashensorit.

Shqyrtimet përkatëse dhe testet të dhëna në standardin/et përkatës/e të harmonizuar/a ose teste të njëvlershme kryhen për të kontrolluar

konformitetin e ashensorit me kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

3.2. Shqyrtimet përfshijnë së paku një nga kërkesat e mëposhtme:

a) shqyrtimi i dokumenteve të referuara në pikën 3.1 të këtij aneksi, për të kontrolluar se ashensori është konform me tipin e aprovuar, të përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit, duke marrë parasysh aneksin IV, pjesa B;

b) shqyrtimi i dokumenteve, të referuara në pikën 3.1 të këtij aneksi, për të kontrolluar nëse ashensori është konform me ashensorin e projektuar dhe të prodhuar në përputhje me një sistem të aprovuar të cilësisë sipas aneksit XI dhe nëse projekti nuk është tërësisht në përputhje me standardet e harmonizuara, me certifikatën e shqyrtimit EU të tipit.

3.3. Testet në ashensor përfshijnë së paku një nga kërkesat e mëposhtme:

a) funksionimin e ashensorit, si bosh ashtu dhe në ngarkesë maksimale, për të siguruar instalim korrekt dhe funksionim të pajisjeve të sigurisë (ndaluesit fundorë, pajisjet bllokuese etj.);

b) funksionimin e ashensorit si në ngarkesë maksimale, ashtu dhe bosh për të siguruar funksionimin korrekt të pajisjeve të sigurisë në rastin e humbjes së fuqisë.

c) testin statik me ngarkesë 1.25 herë sa ngarkesa nominale.

Ngarkesa nominale është ajo e referuar në pikën 6 të aneksit I.

Mbas këtyre testeve, OM-ja kontrollon që të mos ketë shtrembërim apo pérkeqësim, të cilat mund të pengojnë përdorimin e ashensorit.

4. Nëse ashensori përbush kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I, OM-ja vendos ose ka vendosur numrin e tij të identifikimit afér markimit CE, në përputhje me pikat 17 dhe 18 dhe lëshon një certifikatë për inspektimin përfundimtar, e cila jep shqyrtimet dhe testet e kryera.

OM-ja plotëson faqet përkatëse në regjistrin e referuar në pikën 7.2 të aneksit I.

Nëse OM-ja refuzon të lëshojë certifikatën e inspektimit përfundimtar, ai deklaron arsyet e hollësishme për refuzimin dhe tregon masat e nevojshme korrigjuese që duhet të ndërmerrin. Në rastin kur instaluesi ri aplikon për inspektimin përfundimtar, ai e kryen në të njëjtën OM.

## 5. Markimi CE dhe deklarata e konformitetit

5.1. Instaluesi vendos markimin CE në kabinën e çdo ashensori që plotëson kërkesat e shëndetit dhe sigurisë së këtij rregulli teknik dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit ngjitur me markimin CE në kabinën e secilit ashensor

5.2. Instaluesi harton me shkrim deklaratën EU të konformitetit për çdo ashensor dhe për një periudhë 10-vjeçare mbas vendosjes së ashensorit në treg, mban një kopje të deklaratës EU të konformitetit dhe të inspektimit përfundimtar në dispozicion të ISHMT-së. Një kopje e deklaratës EU të konformitetit është e vlefshme për ISHMT-në sipas një kërkese.

## 6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e instaluesit të dhëna në pikën 3.1 dhe 5 të këtij aneksi mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

## ANEKSI VI

### KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË SË PRODUKTIT PËR KOMPONENTËT E SIGURISË PËR ASHENSORË (MODULI E)

1. Konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit për komponentët e sigurisë për ashensorë është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit, me anë të së cilës një OM vlerëson sistemin e cilësisë së një prodhuesi me qëllim që të sigurojë se komponentët e sigurisë për ashensorë janë prodhuar dhe monitoruar në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit, përbushin kërkesat e zbatuara të aneksit I dhe mundësojnë ashensorin në të cilin ato montohen korrektesisht, të përbushë këto kërkesa.

#### 2. Detyrimet e prodhuesit

Prodhuesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për inspektimin përfundimtar dhe testimin e komponentëve të sigurisë për ashensorë, si të specifikuar në pikën 3 të këtij aneksi dhe është subjekt i mbikëqyrjes, si të specifikuar në pikën 4 të këtij aneksi.

#### 3. Sistemi i cilësisë

##### 3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për

vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë, për komponentët e sigurisë për ashensorët në fjalë, vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin e tij, si dhe adresën;
- b) një deklaratë me shkrim se e njëjtë kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjeter;
- c) adresën e ambienteve ku është kryer inspektimi përfundimtar dhe testimi i komponentëve të sigurisë për ashensorë;
- c) të gjithë informacionin përkatës mbi komponentët e sigurisë për ashensorë që do të prodhohen;
- d) dokumentacionin e lidhur me sistemin e cilësisë;
- dh) dokumentacionin teknik të komponentëve të sigurisë për ashensorë të aprovuar dhe një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit.

3.2. Në kuadrin e sistemit të cilësisë, çdo komponent i sigurisë për ashensorë inspektohet dhe kryhen testet e referuara në standartet përkatëse të harmonizuara ose teste të njëvlershme, me qëllim që të sigurohet se ai plotëson kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi. Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e përshtatura nga prodhuesi dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave me shkrim, procedurave dhe instruksioneve. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të garantojë një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm mbi:

- a) objektivat e cilësisë;
  - b) strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;
  - c) shqyrtimet dhe testet që kryhen mbas prodhimit;
  - c) mënyrat e monitorimit për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë;
  - d) regjistrimet e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi, të dhëna mbi testet, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës etj.
- 3.3. OM-ja vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse plotësohen kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi. Ai prezumon

konformitetin me këto kërkesa lidhur me elementet e sistemit të cilësisë që janë në përputhje me specifikimet korresponduese të standardeve përkatëse të harmonizuara.

Mbi eksperiencën në menaxhimin e sistemeve të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së ashensorit dhe njohuri mbi kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

Auditit përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit rishikon dokumentacionin teknik, të referuar në pikën 3.1, shkronja "dh", të këtij aneksi, që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik dhe të kryejë shqyrtimet e nevojshme me synim sigurimin e përputhjes së komponentëve të sigurisë për ashensorë me këto kërkesa.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet e rrjedhura nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe ta mirëmbajë atë që ai të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

3.5. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban OM-në, e cila ka aprovuar sistemin e cilësisë, të informuar për çdo ndryshim të parashikuar të sistemit të cilësisë.

OM-ja vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë vazhdon të plotësojë kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai njofton prodhuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e OM-së

4.1. Mbikëqyrja ka si qëllim të sigurojë se prodhuesi përmbush në vazhdimësi detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime vlerësimi, prodhuesi lejon OM-në të hyjë në ambientet ku kryhet inspektimi përfundimtar, testimi dhe magazinimi, si dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht si:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- b) dokumentacionin teknik;
- c) regjistrimet e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi testet, të dhëna mbi

kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës.

4.3. OM-ja kryen periodikisht auditime që të sigurohet se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport auditimi.

4.4. Për më tepër, OM-ja mund të kryejë vizita të palajmëruara në ambientet e prodhuesit në rastet kur kryhet inspektimi përfundimtar dhe testimi i komponentëve të sigurisë për ashensorë.

Gjatë kohës së realizimit të këtyre vizitave, OM-ja, në rastin kur është e nevojshme, kryen ose detyron kryerjen e testeve që të kontrollojë funksionimin e përshtatshëm të sistemit të cilësisë. Ai i jep prodhuesit një raport mbi vizitën dhe, nëse është kryer një test, edhe reportin e testit.

5. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

5.1. Prodhesi vundos markimin CE dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në çdo komponent të sigurisë për ashensorë që plotëson kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi.

5.2. Prodhesi harton me shkrim deklaratën EU të konformitetit për çdo komponent të sigurisë për ashensorë dhe për një periudhë 10-vjeçare, mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, mban një kopje të saj në dispozicion të ISHMT-së.

Deklarata EU e konformitetit identifikon komponentin e sigurisë për ashensorë për të cilin ajo është hartuar.

6. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, prodhesi mban në dispozicion të ISHMT-së:

a) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1, shkronja "dh" të këtij aneksi;

b) dokumentacionin e referuar në nënpikën 3.1, shkronja "d" të këtij aneksi;

c) informacionin lidhur me ndryshimin e referuar në nënpikën 3.5 të këtij aneksi;

ç) vendimet dhe raportet e OM-së, të cilat janë referuar në paragrafin e tretë të nënpikës 3.5 dhe në nënpikat 4.3 dhe 4.4 të këtij aneksi.

7. Çdo OM informon autoritetin e miratimit për vendimin/et e sistemit të aprovuar të cilësisë që ka lëshuar ose tërhequr dhe periodikisht ose në bazë të kërkesës, mban në dispozicion për

autoritetin e miratimit listën e vendimeve të refuzuara, pezulluara ose të kufizuara.

Çdo OM informon OM-të e tjera në lidhje me sistemet e cilësisë që ajo e ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, vendimet e aprovimit që i ka lëshuar.

#### 8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të dhëna në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 të këtij aneksi, mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

### ANEKSI VII KONFORMITETI I BAZUAR MBI SIGURINË E PLOTË TË CILËSISË PËR KOMPONENTËT E SIGURISË PËR ASHENSORË (MODULI H)

1. Konformiteti i bazuar në sigurinë e plotë të cilësisë për komponentët e sigurisë për ashensorë është procedura e vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM vlerëson sistemin e cilësisë së një prodhesi, për të siguruar se komponentët e sigurisë për ashensorë janë projektuar, prodhuar, inspektuar dhe testuar për të përbushur kërkesat e zbatuara të aneksit I dhe të mundësojë një ashensor, në të cilan ata janë montuar në mënyrë korekte, të përbushë këto kërkesa.

#### 2. Detyrimet e prodhuesit

Prodhuesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për projektimin, prodhimin, inspektimin përfundimtar dhe testimin e komponentëve të sigurisë për ashensorë, si të specifikuar në nënpikën 3 të këtij aneksi dhe është subjekt i mbikëqyrjes si të specifikuar në nënpikën 4 të këtij aneksi.

#### 3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e konformitetit të sistemit të tij të cilësisë vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

##### Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;

b) adresën e ambienteve ku komponentët e sigurisë për ashensorë janë projektuar, prodhuar, inspektuar dhe testuar;

c) të gjithë informacionin përkatës të lidhur me komponentët e sigurisë për ashensorë që prodhohen;

ç) dokumentacionin teknik të përshkruar në pikën 3 në pjesën A, të aneksit IV, për një model të çdo kategorie të komponentit të sigurisë për ashensorë që prodhohet;

d) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

dh) një deklarim me shkrim se e njëjtë kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjetër.

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e komponentëve të sigurisë për ashensorë me kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi. Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e përshtatura nga prodhuesi, të jenë të dokumentuara në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave me shkrim, procedurave dhe instrukSIONeve. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë të garantojë një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm mbi:

a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;

b) specifikimet teknike të projektit, duke përfshirë standardet që zbatohen dhe në rastin kur standardet përkatës të harmonizuar nuk zbatohen ose zbatohen pjesërisht, mjetet, duke përfshirë specifikime të tjera teknike që përdoren, për të siguruar se plotësohen kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi;

c) kontrollin e projektit dhe teknikat e verifikimit të projektit, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren në projektimin e komponentëve të sigurisë për ashensorë;

ç) teknikat korresponduese të prodhimin, të kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren;

d) shqyrtimet dhe testet që kryhen përpëra, gjatë dhe mbas prodhimit dhe shpeshtësia me të cilën ato kryhen;

dh) regjistrimet e cilësisë, të tillë si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi testet, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës;

e) mënyrat e monitorimit përritjen e projektit të kerkuar dhe cilësinë e produktit dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. OM-ja vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmblush kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi. Ai prezumon konformitetin me kërkesat e lidhura me elementet e sistemit të cilësisë që përcaktojnë specifikimet korresponduese të standardit përkatës të harmonizuar.

Përveç eksperiencës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së ashensorit në fjalë dhe njohuri lidhur me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit rishikon dokumentacionin teknik, të referuar në pikën 3.1(ç) të këtij aneksi, për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat e zbatuara të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I dhe kryen shqyrtimet e nevojshme me synimin për të siguruar përputhjen e komponentëve të sigurisë për ashensorë me këto kërkesa.

Vendimi i komunikohet prodhuesit dhe në rastin kur kërkohet, përfaqësuesit të tij të autorizuar. Njoftimi përmban konkluzionet e auditit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhusi merr përsipër të përbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe garanton që mirëmbahet në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.

3.5. Prodhusi mban të informuar OM-në, i cili ka aprovuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë.

OM-ja vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë vazhdon të plotësojë kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e vlerësimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar OM

4.1. Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se prodhusi përbush vazhdimisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime vlerësimi, prodhusi lejon OM-në të hyjë në ambientet e projektimit, prodhimit, inspekimit, testimit dhe magazinimit, si dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht për:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- b) regjistrimet e cilësisë të parashikuara nga sistemi i cilësisë për pjesën e projektit, si rezultatet e analizave, llogaritjeve dhe testeve;
- c) dokumentacionin teknik për komponentët e sigurisë për ashensorë të prodhuar;
- ç) regjistrimet mbi cilësinë të parashikuara nga sistemi i plotë i cilësisë për pjesën e prodhimit, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna testimi, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës.

4.3. OM-ja periodikisht kryen auditime që të sigurojë se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport auditimi.

4.4. Për më tepër, OM-ja mund të kryejë vizita të palajmëruara te prodhuesi. Gjatë kohës së kryerjes së këtyre vizitatave, në rastin kur është e nevojshme, OM-ja kryen teste ose detyron kryerjen e testeve që të kontrollojë funksionimin e përshtatshëm të sistemit të cilësisë. Ai i jep prodhuesit një raport mbi vizitën dhe raportin e testit nëse është kryer një test.

#### 5. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

5.1. Prodhesi vendos markimin CE dhe nën përgjegjësinë e OM-së të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në çdo komponent të sigurisë për ashensorë që plotëson kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi.

5.2. Prodhesi harton me shkrim një deklaratë të konformitetit për çdo komponent të sigurisë për ashensorë dhe, për një periudhë 10-vjeçare mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, mban një kopje të saj në dispozicion të ISHMT-së. Deklarata EU e konformitetit identifikon komponentin e sigurisë për ashensorë për të cilin ajo është hartuar.

6. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, prodhesi mban në dispozicion të ISHMT-së:

- a) dokumentacionin teknik të referuar në nënpikën 3.1(dh) të këtij aneksi;
- b) dokumentacionin e referuar në nënpikën 3.1(ç) të këtij aneksi;
- c) informacionin lidhur me ndryshimin të referuar në nënpikën 3.5 të këtij aneksi;
- ç) vendimet dhe raportet e OM-së të cilat janë

referuar në paragrafin e tretë të pikës 3.5 dhe në pikat 4.3 dhe 4.4 të këtij aneksi.

7. Çdo OM informon autoritetin e miratimit për vendimin/et e sistemit të aprovuar të cilësisë që ka lëshuar ose tërhequr dhe periodikisht ose në bazë të kërkesës, mban në dispozicion të autoritetit të miratimit listën e këtyre vendimeve të refuzuara, të pezulluara ose të kufizuara.

Çdo OM informon OM-të e tjera në lidhje me sistemet e cilësisë që ajo ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, vendimet e aprovimit që i ka lëshuar.

Për një periudhë 15-vjeçare nga data e lëshimit, OM-ja mban një kopje të vendimit të aprovimit të lëshuar, anekset dhe shtesat e saj, si dhe po ashtu dhe dokumentacionin teknik.

#### 8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të dhëna në pikat 3.1, 3.5 dhe 5 të këtij aneksi mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

### ANEKSI VIII KONFORMITETI I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E NJËSISË (MODULI G)

1. Konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit me anë së cilës një OM vlerëson nëse një ashensor i përbush kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I.

#### 2. Detyrimet e instaluesit

2.1. Instaluesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë konformitetin e ashensorit me kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I.

2.2. Instaluesi kërkon verifikimin e njësisë vetëm në një OM të zgjedhur nga ai vetë. Kërkesa përmban:

- a) emrin dhe adresën e instaluesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;
- b) vendin ku ashensori është instaluar;
- c) një deklaratë me shkrim që tregon se një kërkesë e ngjashme nuk është paraqitur në një OM tjeter;
- ç) dokumentacionin teknik.

3. Dokumentacioni teknik mundëson një vlerësim të konformitetit të ashensorit me kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të dhëna në aneksin I.

Dokumentacioni teknik përmban së paku elementet e mëposhtme:

- a) një përshkrim të ashensorit;
- b) vizatimet dhe diagramet e projektit dhe prodhimit;
- c) shpjegime të nevojshme mbi kuptimin e vizatimeve dhe diagrameve dhe funksionimin e ashensorit;
- ç) një listë të kërkesave thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë të marra parasysh;

d) listën e standardeve të harmonizuara, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referimet e të cilave janë pjesë përbërëse e këtij rregulli teknik dhe në rastin kur nuk zbatohen standardet e harmonizuara, përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të këtij rregulli teknik, duke përfshirë listën e specifikimeve përkatëse teknike të zbatuara. Në rastin e standardeve të harmonizuara të zbatuara pjesërisht, dokumentacioni teknik specifikon pjesët të cilat janë zbatuar;

dh) kopje të certifikatave të shqyrtimit EU të tipit të komponentëve të sigurisë për ashensorë të montuar në ashensor;

e) rezultatet e llogaritjeve të projektimit të kryera ose të nënkontraktuara nga instaluesi;  
ë) raportet e testimit;

f) një kopje të instrukSIONEVE, të referuara në pikën 7.2 të aneksit I.

#### 4. Verifikimi

OM-ja e zgjedhur nga instaluesi shqyrton dokumentacionin teknik dhe ashensorin dhe kryen testet përkatëse, si të dhëna në standardin/et e harmonizuar/a ose teste të njëvlershme për të kontrolluar konformitetin e tij me kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I. Testet përfshijnë së paku testet e referuara në pikën 3.3 të aneksit V.

Nëse ashensori plotëson kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I, OM-ja lëshon një certifikatë konformiteti lidhur me testet e kryera.

OM-ja plotëson faqet korresponduese në regjistrin e referuar në pikën 7.2 të aneksit I.

Nëse OM-ja refuzon të lëshojë certifikatën e konformitetit, ai deklaron të detajuara arsyet e refuzimit të tij dhe tregon masat korrigjuese të nevojshme për t'u marrë. Kur instaluesi ripërsërit verifikimin e njësisë, ai e bën në të njëjtën OM.

5. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

5.1 Instaluesi vendos markimin CE në kabinën e çdo ashensori që plotëson kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të këtij rregulli teknik dhe nën përgjegjësinë e OM-së, e referuar në pikën 2.2 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në kabinën e çdo ashensori.

5.2. Instaluesi harton me shkrim një deklaratë të konformitetit për çdo ashensor dhe për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, mban një kopje të saj në dispozicion të ISHMT-së. Një kopje e deklaratës EU të konformitetit, sipas një kërkesë, bëhet e vlefshme për ISHMT-së.

6. Për një periudhë 10-vjeçare nga data e vendosjes së ashensorit në treg, instaluesi mban me dokumentacionin teknik një kopje të certifikatës së konformitetit në dispozicion të ISHMT-së.

#### 7. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e instaluesit, të dhëna në pikat 2.2 dhe 6 të këtij aneksi, mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

### ANEKSI IX KONFORMITETI I TIPIT ME KONTROLL RASTËSOR PËR KOMPONENTËT E SIGURISË PËR ASSENSORË (MODULI C2)

1. Konformiteti i tipit me kontroll rastësor është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM kryen kontrollin mbi komponentët e sigurisë për ashensorë për të siguruar se ato janë në konformitet me tipin e aprovar, si të përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe plotëson kërkesat e zbatuara të aneksit I, si dhe i mundësojnë ashensorit, në të cilin ata montohen, të përmbushë këto kërkesa.

#### 2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë që komponentët e prodhuar të sigurisë për ashensorë të plotësojnë kushtet e referuara në nënpikën 1 të këtij aneksi.

3. Prodhuesi paraqet një kërkesë për kontrollin rastësor vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

#### Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim se e njëjtë kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjetër;

c) të gjithë informacionin përkatës mbi komponentët e prodhuar të sigurisë për ashensorë;

ç) adresën e ambienteve ku merret mostra e komponentëve të sigurisë për ashensorë.

4. OM-ja kryen ose detyron kryerjen e kontrolleve në intervale rastësore mbi komponentët e sigurisë për ashensorë. Një mostër e përshtatshme e përfunduar e komponentëve të sigurisë për ashensorë, e marrë në vendin e prodhimit nga OM-ja, shqyrtohet dhe kryhen testet e duhura, të dhëna në standartet përkatëse të harmonizuara ose kryhen teste ekuivalente, të dhëna në specifikimet teknike, për të kontrolluar nëse komponenti i sigurisë për ashensorë plotëson kushtet e referuara në nënpikën 1 të këtij aneksi. Në rastet kur një ose më shumë nga komponentët e sigurisë për ashensorë të kontrolluar janë me mospërputhje, OM-ja merr masat përkatëse.

Çështjet që merren parasysh gjatë kontrollit të komponentëve të sigurisë për ashensorë përcaktohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet OM-së, përgjegjëse për këtë procedurë, duke marrë parasysh karakteristikat thelbësore të komponentëve të sigurisë për ashensorë.

OM-ja lëshon një certifikatë të konformitetit të tipit lidhur me shqyrtimet dhe testet e kryera.

5. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

5.1. Prodhuesi vendos markimin CE dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në çdo komponent të sigurisë për ashensorë që plotëson kushtet e referuara në pikën 1 të këtij aneksi.

5.2. Prodhuesi harton me shkrim deklaratën EU të konformitetit për çdo komponent të sigurisë për ashensorë dhe mban një kopje të saj në dispozicion të ISHMT-së për një periudhë 10-vjeçare mbasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg. Deklarata EU e konformitetit identifikon komponentin e sigurisë për ashensorë për të cilin ajo është hartuar.

#### 6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit. Një përfaqësues i autorizuar nuk përbush detyrimet e dhëna në pikën 2 të këtij aneksi.

### ANEKSI X KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË SË PRODUKTIT PËR ASHENSORË (MODULI E)

1. Konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM-ja vlerëson sistemin e cilësisë së produktit të një instaluesi për të siguruar se ashensorët janë në konformitet me tipin e aprovuar, si të përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit ose me një ashensor të projektuar dhe të prodhuar nën një sistem të plotë të aprovuar të cilësisë, në përputhje me aneksin XI dhe plotësojnë kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

#### 2. Detyrimet e instaluesit

Instaluesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për inspektimin përfundimtar dhe testimin e ashensorit, si të specifikuar në pikën 3 të këtij aneksi dhe është subjekt i mbikëqyrjes, si të specifikuar në pikën 4 të këtij aneksi.

#### 3. Sistemi i cilësisë

3.1. Instaluesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për ashensorët në fjalë vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

#### Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e instaluesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;

- b) të gjithë informacionin përkatës mbi ashensorët që instalohen;
- c) dokumentacionin mbi sistemin e cilësisë;
- ç) dokumentacionin teknik të ashensorit që instalohet;
- d) një deklarim me shkrim se e njëjtë kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjetër.

3.2. Në kuadër të sistemit të cilësisë, çdo ashensor shqyrtohet dhe kryhen testet e duhura, si të dhëna në standartet përkatëse të harmonizuara ose kryhen teste ekuivalente, me qëllim që të sigurohet konformiteti i tij me kërkesat e zbatuara thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e përshtatura nga instaluesi dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave me shkrim, procedurave dhe instruksioneve. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë lejon një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm mbi:

- a) objektivat e cilësisë;
- b) strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;
- c) shqyrtimet dhe testet që kryhen përpara vendosjes në treg, duke përfshirë së paku testet e dhëna në pikën 3.3 në aneksin V;
- ç) mënyrat e monitorimit për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë;
- d) regjistimet e cilësisë, të tillë si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi testet, të dhëna mbi kalibrin, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës.

3.3. OM vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij Aneksi, lidhur me elementet e sistemeve të cilësisë që përpushten me specifikimet korresponduese të standardit përkatës të harmonizuar.

Ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së ashensorit në fjalë dhe njohuri lidhur me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e instaluesit dhe një vizitë në vendin e instalimit.

Vendimi i komunikohet instaluesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vlerësimin e arsyetur të vendimit.

3.4. Instaluesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe siguron se mirëmbahet në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.

3.4.1. Instaluesi informon OM-në, që ka aprovuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të parashikuar në sistem.

3.4.2. OM-ja vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë vazhdon të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai njofton instaluesin për vendimin e tij ose në rastin kur kërkohet, përfaqësuesin e tij të autorizuar. Njoftimi përmban konkluzionet e vlerësimit dhe vendimin e arsyetur të vlerësimit. OM-ja vendos ose duhet të kërkojë të vendoset numri i tij i identifikimit pranë markimit CE, në përpunje me pikat 17 dhe 18.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e OM-së

4.1. Mbikëqyrja ka si qëllim të sigurojë se instaluesi përmbush në vazhdimësi detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Instaluesi lejon për qëllime vlerësimi hyrjen e OM-së në ambientet e instalimit dhe testimini dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- b) dokumentacionin teknik;
- c) regjistimet e cilësisë, të tillë si raporte inspektimi dhe të dhëna të testiminit, të dhëna kalibrimi, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë.

4.3. OM-ja kryen periodikisht auditime për të siguruar se instaluesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i paraqet instaluesit një raport auditimi.

4.4. Për më tepër, OM-ja mund të kryejë vizita të palajmëruara në vendet e instalimit të ashensorit.

Gjatë kohës së këtyre vizitave, në rastin kur është e nevojshme, OM-ja kryen teste ose detyron kryerjen e tyre që të kontrollojë funksionimin e përshtatshëm të sistemit të cilësisë dhe ashensorin. Ai i jep instaluesit një raport mbi vizitën dhe reportin mbi testin nëse janë kryer teste.

5. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, instaluesi mban në dispozicion të ISHMT-së:

a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi;

b) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi;

c) informacionin e lidhur me ndryshimet, i referuar në pikën 3.4.1 të këtij aneksi;

ç) vendimet dhe raportet nga OM-ja, të cilat janë referuar në paragrafin e dytë të pikës 3.4.2 dhe në pikat 4.3 dhe 4.4 të këtij aneksi.

6. Çdo OM informon autoritetin e miratimit të sistemit të cilësisë mbi vendimin/et e aprovimit të lëshuar/a ose të hequr/a dhe periodikisht, sipas një kërkese, dërgon tek autoriteti i miratimit listën e vendimeve të aprovuara, refuzuara, pezulluara ose kufizuara.

Çdo OM informon OM-të e tjera vendimin/et e aprovimit të sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar ose hequr dhe sipas një kërkese vendimin/et e aprovimit që ai ka lëshuar.

7. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

7.1. Instaluesi vodos markimin CE në kabinën e çdo ashensori, i cili përmbush kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të këtij rregulli teknik dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në kabinën e çdo ashensori, në afërsi të markimit CE.

7.2. Instaluesi harton me shkrim një deklaratë të konformitetit për çdo ashensor dhe për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg mban një kopje të deklaratës së konformitetit në dispozicion të ISHMT-së. Një kopje e deklaratës EU të konformitetit bëhet e vlefshme për ISHMT-në, sipas një kërkese.

#### 8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e instaluesit, të dhëna në pikat 3.1, 3.4.1, 5 dhe 7 të këtij aneksi, mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

## ANEKSI XI

### KONFORMITETI I BAZUAR NË SIGURINË E PLOTË TË CILËSISË, DUKE ZBATUAR SHQYRTIMIN E PROJEKTIT PËR ASHENSORIN (MODULI H1)

1. Konformiteti i bazuar në sigurinë e plotë të cilësisë, duke zbatuar shqyrtimin e projektit për ashensorë, është procedura e vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM vlerëson sistemin e cilësisë së një instaluesi dhe në rastin e përshtatshëm projektin e ashensorit, që të sigurohet se ashensorët përbushin kërkesat e zbatuara të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

#### 2. Detyrimet e instaluesit

Instaluesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për projektin, prodhimin, montimin, instalimin, inspektimin përfundimtar dhe testimin e ashensorit, si të specifikuar në pikën 3 të këtij aneksi dhe është subjekt i mbikëqyrjes, si të specifikuar në pikën 4 të këtij aneksi. Përputhja e projektit teknik të ashensorëve shqyrtohet në përputhje me pikën 3.3 të këtij aneksi.

#### 3. Sistemi i cilësisë

3.1. Instaluesi paraqet një kërkësë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e instaluesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, po ashtu emrin dhe adresën e tij;

b) të gjithë informacionin përkatës mbi ashensorët që instalohen, veçanërisht informacionin i cili sqaron lidhjen ndërmjet projektit dhe funksionimit të ashensorit;

c) dokumentacionin mbi sistemin e cilësisë

ç) dokumentacionin teknik, të përshkruar në pikën 3, në pjesën B, të aneksit IV;

d) një deklarim me shkrim se e njëjtë kërkësë nuk është paraqitur në një tjetër OM.

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e ashensorëve me kërkesat e zbatuara të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitave të përshtatura nga instaluesi dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave me shkrim, procedurave dhe instrukSIONeve. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë të lejojë një interpretim uniform të

programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshmë mbi:

a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitet dhe kompetencën e menaxhimit lidhur me cilësinë e projektit dhe produktit;

b) specifikimet e projektit teknik, duke përfshirë standardet e zbatuara dhe në rastin kur standardet e harmonizuara nuk zbatohen plotësisht, mënyrat, duke përfshirë specifikimet përkatëse teknike që zbatohen për të siguruar se plotësohen kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë, të dhëna në aneksin I;

c) kontrollin e projektit dhe teknikat e verifikimit të projektit, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren gjatë projektimit të ashensorëve;

ç) shqyrtimet dhe testet që kryhen për njohjen e furnizueseve të materialeve, komponentëve dhe nënnjësive;

d) montimin korrespondues, instalimin, kontrollin e cilësisë dhe teknikat mbi sigurimin e cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren;

dh) shqyrtimet dhe testet që kryhen përpara (inspektimi i kushteve të instalimit, kolona, vendi i makinerisë etj.), gjatë dhe mbas instalimit (duke përfshirë së paku testet e dhëna në pikën 3.3 të aneksit V);

e) regjistrimet e cilësisë, të tillë si raporte inspekimi dhe të dhëna mbi testet, të dhëna kalibrimi, raporte mbi kualifikimet e personelit përkatës;

ë) mënyrat e monitorimit për arritjen e projektit të kërkuar dhe cilësinë e produktit dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

### 3.3. Shqyrtimi i projektit

3.3.1. Kur projekti nuk është plotësisht në përputhje me standardet e harmonizuara, OM-ja vlerëson nëse projekt i është në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të përcaktuara në aneksin I dhe nëse po, i lëshon instaluesit një certifikatë shqyrtimi EU të projektit, duke deklaruar kufijtë e vlefshmërisë së certifikatës dhe duke dhënë hollësitë e kërkua e për identifikimin e projektit të miratuar.

3.3.2. Në rastin kur projekti nuk përbush kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe

sigurinë, të dhëna në aneksin I, OM-ja refuzon lëshimin e një certifikate të shqyrtimit EU të projektit dhe informon menjëherë instaluesin duke i dhënë arsyet e detajuara për refuzimin e tij.

OM-ja duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim mbi gjendjen përgjithësish të pranuar të teknologjisë bashkëkohore që tregon se projekt i aprovuar nuk përbush kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të përcaktuara në aneksin I dhe përcakton nëse këto ndryshime kërkojnë hetime të mëtejshme.

Nëse është kështu, OM-ja informon menjëherë instaluesin.

3.3.3. Instaluesi mban të informuar OM-në që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit EU të projektit për çdo ndryshim në projektin e aprovuar, i cili mund të ndikojë në konformitetin me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I ose kushtet për vlefshmërinë e certifikatës. Këto ndryshime kërkojnë aprovime shtesë prej OM-së që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit EU të projektit, në formën e një shtese në certifikatën originale të shqyrtimit EU të projektit.

3.3.4. Çdo OM informon autoritetin e miratimit lidhur me certifikatat e shqyrtimit EU të projektit dhe/ose të çdo shtese që ka lëshuar ose hequr dhe periodikisht, sipas një kërkese, mban në dispozicion të autoritetit të miratimit, listën e certifikatave të shqyrtimit EU të projektit dhe/ose të shtesave të tyre të refuzuara, të térhequra ose të kufizuara.

Çdo OM informon OM-në e tjera në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të projektit dhe/ose të shtesave, të cilat ai i ka refuzuar, térhequr, pezulluar ose kufizuar dhe sipas kërkësës, të certifikatave dhe/ose shtesave të cilat i ka lëshuar.

3.3.5. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, instaluesi mban një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të projektit, anekset e saj dhe shtesat, së bashku me dokumentacionin teknik, në dispozicion të ISHMT-së.

### 3.4. Vlerësimi i sistemit të cilësisë

OM-ja vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përbush kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi. Ai prezumon konformitetin me këto kërkesa lidhur me elementet e sistemeve të cilësisë që përbushin specifikimet korresponduesë të standardit përkatës të harmonizuar.

Ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së ashensorit në fjalë dhe njohuri mbi kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të dhëna në aneksin I. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e instaluesit dhe një vizitë në vendin e instalimit.

Ekipi i auditimit rishikon dokumentacionin teknik, të referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi, për të verifikuar zotësinë e instaluesit në identifikimin e kërkesave të zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë, të dhëna në aneksin I dhe kryen shqyrtimet e nevojshme për të siguruar përporthjen e ashensorit me këto kërkesa.

Vendimi i njoftohet instaluesit ose, në rastin kur kërkohet, përfaqësuesit të tij të autorizuar. Njoftimi përmban konkluzionet e vlerësimit dhe vlerësimin e arsyetuar të vendimit.

3.5. Instaluesi plotëson detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe siguron se mirëmbahet në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.

Instaluesi mban OM-në, që ka aprovuar sistemin e cilësisë, të informuar për çdo ndryshim të parashikuar në sistem.

OM vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë vazhdon të përbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai njofton instaluesin për vendimin e tij ose nëse kërkohet, përfaqësuesin e tij të autorizuar. Njoftimi përmban konkluzionet e vlerësimit dhe vlerësimin e arsyetuar në vendim.

OM-ja vendos ose kërkon të vendoset numri i tij i identifikimit pranë markimit CE, në përporthje me pikat 17 dhe 18.

#### 4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e OM-së

4.1. Mbikëqyrja ka si qëllim të sigurojë se instaluesi përbush vazhdimin e detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime vlerësimi, instaluesi lejon OM-në të hyjë në ambientet e projektimit, prodhimit, montimit, instalimit, inspektimin, testimin dhe magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) regjistrimet e cilësisë të parashikuara në sistemin e cilësisë për pjesën e projektit, si rezultate të analizave, llogaritjeve, testeve;

c) regjistrimet mbi cilësinë të parashikuara

nga sistemi i cilësisë për sa i përket pranimit të furnizimeve dhe instalimit, si raporte inspekëtimi dhe të dhëna mbi testet, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimin e personelit përkatës.

4.3. OM-ja kryen periodikisht auditime për të siguruar se instaluesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i paraqet instaluesit një raport auditimi.

4.4. Për më tepër, OM-ja mund të kryejë vizita të palajmëruara në ambientet e instaluesit ose në vendin e instalimit të një ashensori. Gjatë këtyre vizitave, OM-ja, në rastin kur kërkohet, mund të kryejë teste ose detyron kryerjen e testeve që kontrollojnë funksionimin e përshtatshëm të sistemit të cilësisë. Ai i jep instaluesit një raport mbi vizitën dhe raportin e testimtit nëse janë kryer teste.

5. Për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, instaluesi mban në dispozicion të ISHMT-së:

a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi;

b) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi;

c) informacionin e lidhur me ndryshimet e referuara në paragrafin e dytë të pikës 3.5 të këtij aneksi;

ç) vendimet dhe raportet e OM, të cilat janë referuar në paragrafin e katërt të pikës 3.5 dhe në pikat 4.3 dhe 4.4 të këtij aneksi.

6. Çdo OM informon autoritetin e miratimit të sistemit të plotë të cilësisë mbi vendimin/et e aprovimit të lëshuar/a ose të tërhequr/a dhe periodikisht, sipas një kërkese, mban në dispozicion të autoritetit të miratimit listën e vendimeve të aprovuara, refuzuara, pezulluara ose të tërhequra.

Çdo OM informon OM-të e tjera mbi vendimin/et e aprovimit të sistemit të cilësisë, të cilat i ka refuzuar, pezulluar ose tërhequr dhe sipas një kërkese, vendimet e aprovimit, të cilat i ka lëshuar.

Për një periudhë 15-vjeçare nga data e lëshimit, OM-ja mban një kopje të vendimit të aprovimit të lëshuar, anekset dhe shtesat e tij, si dhe dokumentacionin teknik.

7. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

7.1. Instaluesi vendos markimin CE në kabinën e çdo ashensori, i cili përbush kërkesat

thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të këtij rregulli teknik dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të këtij të fundit në afërsi të markimit CE në kabinën e çdo ashensori.

7.2. Instaluesi harton me shkrim një deklaratë EU të konformitetit për çdo ashensor, si dhe për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg, mban një kopje të deklaratës së konformitetit në dispozicion të ISHMT-së. Një kopje e deklaratës EU të konformitetit, sipas një kërkesë, është e vlefshme për ISHMT-në.

### 8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e instaluesit, të dhëna në pikat 3.1, 3.4.1, 5 dhe 7 të këtij aneksi, mund të përbushen nga përfaqësuesi i tij autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, të parashikuara se ato janë të specifikuara në aktin e përfaqësimit.

## ANEKSI XII

### KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR MBI SIGURINË E CILËSISË NË PRODHIM PËR ASHENSORËT (MODULI D)

1. Konformiteti i tipit i bazuar në sigurinë e cilësisë në prodhim për ashensorë është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit me anë të së cilës një OM vlerëson sistemin e cilësisë në prodhim të një instaluesi, që të sigurohet se ashensorët e instaluar janë në konformitet me tipin e aprovuar, si të përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit ose me një ashensor të projektuar dhe të prodhuar nën një sistem të aprovuar të cilësisë sipas aneksit XI dhe përbushin kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë, të dhëna në aneksin I.

### 2. Detyrimet e instaluesit

Instaluesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, montimin, instalimin inspektimin përfundimtar dhe testimin e ashensorëve, si të specifikuar në pikën 3 të këtij aneksi dhe janë subjekt i mbikëqyrjes, si të specifikuar në pikën 4 të këtij aneksi.

### 3. Sistemi i cilësisë

3.1. Instaluesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë vetëm në një OM të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

a) emrin dhe adresën e instaluesit dhe nëse

kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin e tij, si dhe po ashtu adresën;

b) të gjithë informacionin përkatës mbi ashensorët;

c) dokumentacionin mbi sistemin e cilësisë;

ç) dokumentacionin teknik të ashensorit që instalohet;

d) një deklarim me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur në një OM tjeter.

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e ashensorëve me kërkesat e zbatuara thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë, të dhëna në aneksin I.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e përshtatura nga instaluesi të janë të dokumentuara me shkrim në një mënyrë sistematike dhe të rrëgullt në formën e politikave, procedurave dhe instrukSIONEVE. Dokumentacioni lejon një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve të cilësisë.

Ai përmban një përshkrim të mjaftueshëm të:

a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësive dhe kompetencës së menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;

b) prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikat e sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që përdoren;

c) shqyrtimet dhe testet që përdoren përpara, gjatë dhe mbas instalimit;

ç) regjistrimet e cilësisë, të tillë si raporte inspektimi dhe të dhëna testimi, të dhëna kalibrimi, raporte mbi kualifikimin e personelit të përfshirë;

d) mënyrat e monitorimit për arritjen cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. OM-ja vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përbush kërkesat e referuara në pikën 3.2 të këtij aneksi. Ai prezumon konformitetin me këto kërkesa të lidhura me elementet e sistemit të cilësisë që përcaktojnë specifikimet korresponduese të standardit përkatës të harmonizuar.

Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së ashensorit në fjalë dhe njoħuri mbi kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në aneksin I.

Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e instaluesit dhe një vizitë në vendin e instalimit.

Vendimi i njoftohet instaluesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vlerësimin e arsyetuar të vendimit.

3.4. Instaluesi merr përsipër të përbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe e mirëmban atë që ai të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

3.4.1. Instaluesi mban OM-në që ka miratuar sistemin e cilësisë të informuar për çdo ndryshim të parashikuar në sistem.

3.4.2. OM-ja vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vends nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë vazhdon të përbushë kërkesat e referuara në nënpikën 3.2 të këtij aneksi ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Ai njofton instaluesin mbi vendimin e tij ose sipas rastit përfaqësuesin e tij të autorizuar. Njoftimi përmban konkluzionet e vlerësimit dhe vlerësimin e arsyetuar të vendimit.

OM-ja vends ose kërkon të vendoset numri i tij i identifikimit pranë markimit CE në përputhje me pikat 17 dhe 18.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e OM-së

4.1. Mbikëqyrja ka si qëllim të sigurojë se instaluesi përbush në vazhdimësi detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime vlerësimi, instaluesi lejon hyrjen e OM-së në vendet e prodhimit, montimit, instalimit inspektimit testimit dhe magazinimit, si dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) dokumentacionin teknik;

c) regjistrimet e cilësisë, të tillë si raporte inspektimi dhe të dhëna testimi, të dhëna mbi kalibrimet, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë.

4.3. OM-ja kryen periodikisht auditime që të sigurohet se instaluesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i paraqet instaluesit një raport auditimi.

4.4. Për më tepër, OM-ja mund të kryejë vizita të palajmëruara tek instaluesi. Gjatë vizitave të tillë, OM-ja, në rastin kur kërkohet, mund të kryejë teste ose detyron kryerjen e tyre për të verifikuar se sistemi i cilësisë funksionon normalisht. OM-ja i jep instaluesit një raport mbi vizitën dhe raportin e testimit nëse është kryer një test.

5. Instaluesi mban në dispozicion të ISHMT-së, për një periudhë 10-vjeçare mbasi ashensori është vendosur në treg:

a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1 (c) të këtij aneksi;

b) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1(c) të këtij aneksi;

c) informacionin lidhur me ndryshimet e referuara në pikën 3.4.1 të këtij aneksi;

ç) vendimet dhe raportet e OM-së, të referuara në paragrafin e dytë të pikës 3.4.2 dhe në pikat 4.3 dhe 4.4 në këtë aneks.

6. Çdo OM informon autoritetin e miratimit të sistemit të aprovuar të cilësisë mbi vendimin/et e aprovimit të lëshuara ose të tэрhequra dhe periodikisht, sipas një kërkese, vë në dispozicion të autoritetit të miratimit listën e vendimeve të aprovuara, të refuzuara, të pezulluara ose të tэрhequra.

Çdo OM informon OM-të e tjera mbi vendimin/et e aprovimit të sistemit të cilësisë, të cilat i ka refuzuar, pezulluar ose tэрhequr dhe sipas një kërkese, vendimet e aprovimit, të cilat i ka lëshuar.

7. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

7.1. Instaluesi vends markimin CE në kabinën e çdo ashensori, i cili përbush kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë të dhëna në ketë rregull teknik dhe nën përgjegjësinë e OM-së, të referuar në pikën 3.1 të këtij aneksi, numrin e identifikimit të OM-së në afërsi të markimit CE në kabinën e çdo ashensori.

7.2. Instaluesi harton me shkrim deklaratën e konformitetit për çdo ashensor dhe mban një kopje të deklaratës në dispozicion të ISHMT-së për 10 vjet mbasi ashensori është vendosur në treg. Një kopje e deklaratës EU të konformitetit është e vlefshme, sipas një kërkese, për ISHMT-në.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e instaluesit të dhëna në nënpikat 3.1, 3.4.1, 5 dhe 7 të këtij aneksi mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në përputhje me specifikimet e dhëna në aktin e përfaqësimit.

